



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



# Basic Education Program



Zhvillimi i Shkathësive të  
Shekullit 21 përmes  
**TË NXËNIT LIDHUR  
ME MJEDISIN**



**Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjensionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.**

---

---

**Doracaku është financuar nga populli amerikan përmes Agjensionit të SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për arsimin themelor (Basic Education Program të USAID-it) të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën Arsimore të Kosovës (KEC).**

---



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*



# Basic Education Program

**Zhvillimi i Shkathësive të  
Shekullit 21 përmes  
TË NXËNIT LIDHUR  
ME MJEDISIN**

## **HARTUAR NGA**

Arbresha Zeqiri-Meha

Linda Grapci-Kotori

## **REDAKTIMI**

Florina Salihu

## **DIZAJNI GRAFIK**

indesign

## **BOTIMI I PARË**

Tetor, 2012

---

## **FALENDERIME:**

Basic Education Program (Programi i Arsimit Themelor) u shprehë falenderime të sinqerta të gjithë atyre që kontribuan në realizimin e këtij doracak. Po ashtu i jemi mirënjohës Z. Xhavit Rexhaj për këshillat dhe ndihmën e tij profesionale e gjuhësore. Falenderime të veçanta u takojnë drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollave të mesme të ulëta "Hilmi Rakovica", "Shkolla e Gjellbër" dhe "Iliria" në Prishtinë, "Zekeria Rexha" në Gjakovë, "Selman Riza" në Fushë-Kosovë dhe "Bedri Gjinaj" në Mitrovicë që morën pjesë në realizimin e aktiviteteve të ndryshme të përfshira në këtë doracak.

---

# PËRMBAJTJA

<b>1. Mirësevini</b> .....	6
<b>2. Tabela e shkurtesave</b> .....	7
<b>3. Si mund të ju ndihmojë doracaku?</b> .....	8
<b>4. Si ta përdorim doracakun?</b> .....	9
4.1 Legjenda .....	9
<b>5. Si duket të nxënit lidhur me mjedisin?</b> .....	12
<b>6. Pse na duhet fokusi i ri?</b> .....	13
6.1 Të nxënit dhe ndërveprimi ndërkurrikular .....	14
6.2 Çfarë mundësish sjellim ne .....	15
<b>7. Koncepti i ri</b> .....	16
7.1 Fushëveprimi dhe përmbajtja e NLM-së .....	16
7.2 Roli i nxënësve dhe mësimitdhënësve dhe komunitetit .....	17
<b>8. Metodologjia e Re</b> .....	18
8.1 Parimet e Përgjithshme .....	18
8.1.1 Lidhja me kompetencat e MASHT-it .....	19
8.1.2 Karakteristikat .....	20
8.2 Ilustrim i strategjive të reja mësimore: Hulumtimi në veprim .....	25
<b>9. Qasja e re</b> .....	26
9.1 Fushata .....	26
9.2 Sfidat e dizajnit .....	27
9.3 Klubet e Gjelbra .....	33
<b>10. Mënyra të reja për vlerësim: VPN</b> .....	38
10.1 Mënyrat e vetëvlerësimit në shkolla .....	39
10.2 Arsyetimi dhe Modelet e Mënyrave të Vetëvlerësimit .....	39
10.3 Veprimi, Planifikimi dhe Monitorimi i Mënyrave për Vetëvlerësim .....	39
<b>11. Pse të zbatohet NLM-ja në nivel të shkollës?</b> .....	40
<b>12. Faqet tuaja personale</b> .....	41
12.1 Portfolio e Mësimdhënësit (Dosja) .....	41
<b>13. Referencat</b> .....	43
<b>DORACAKU I FUSHATËS për Klubet e Gjelbra</b> .....	45
<b>INSTRUMENTI SHKOLLOR I VETVLERËSIMIT NË MËSIMIN E NLM-së</b> .....	61



# 1. Mirësevini

Doracak i të nxënit në lidhje me mjedisin i është dedikuar mësimdhënësve të shkencave natyrore. Ky doracak poashtu përmban ide të mësimdhënies për lëndët tjera që kanë të bëjnë me të nxënit në lidhje me mjedisin. Grupi i synuar janë të gjithë mësimdhënësit që në punën e tyre i trajtojnë çështjet mjedisore, siç janë mësimdhënësit e biologjisë, kimisë, fizikës, por edhe ata të gjeografisë, edukimit qytetar dhe edukimit fizik, madje edhe ata të gjuhëve.

Poashtu, doracaku përputhet me kurikulën e re të Kosovës, të bazuar në kompetenca.

Të nxënit lidhur me mjedisin (NLM) ka qenë i kufizuar për shkak të mungesës së pajisjeve praktike dhe mungesës së aktiviteteve. Për të kuptuar konceptet e ambientit, nxënësve duhet t'u ipet mundësia e pjesëmarrjes në aktivitete që kanë të bëjnë me mjedisin. Shumica e fëmijëve (dhe të rriturve) mësojnë më lehtë nëse kanë mundësi që praktikisht ta zhvillojnë një aktivitet. Një proverbë kineze e paraqet këtë shumë thjeshtë:

***Unë dëgjoj ... Unë harroj***  
***Unë shoh ... Unë mbaj mend***  
***Unë bëj ... Unë kuptoj***

Disa shkolla në Kosovë tashmë e kanë prezantuar qasjen e re që paraqitet në këtë doracak. Këto shkolla janë duke e aplikuar qasjen praktike në mësimdhënie.

Ky doracak ka për qëllim që të ju ndihmojë ti zhvillonit njohuritë tuaja dhe të kuptoni "Të nxënit lidhur me mjedisin (NLM)". Shpresojmë se do të ju ndihmojë gjatë orëve të mësimt dhe do të ju ofrojë shembuj praktik të aktiviteteve.

Doracak do të ju njoftojë me strategji të reja. Këto strategji përfshijnë: ti bëjmë qëllimet e orës së mësimt të qarta tek nxënësit, të ofrojmë kriteret e qarta për sukses, ta zhvillojmë të menduarit kreativ, të zgjedhim sfidat e dizajnit, punën grupore dhe të komunikuarit efektiv, mbështetjen tek miku, shembuj konkretë, kritikizem konstruktiv, dhe poashtu vlerësimin dhe planifikimin e të nxënit. Arsyeja kryesore pse kjo qasje është më efektive është sepse ndihmon nxënësit të zhvillojnë të kuptuarit.




## 2. Tabela e shkurtesave

<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
<b>USAID</b>	Agjensioni i SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar
<b>FHI 360</b>	Family Health International
<b>BEP</b>	Basic Education Program
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>NLM</b>	Të nxënit lidhur me mjedisin
<b>VpN</b>	Vlerësimi për Nxënie
<b>ViN</b>	Vlerësimi i Nxënies
<b>HV</b>	Hulumtimi në Veprim
<b>NPM</b>	Ngritja Profesionale e Mësimdhënësve
<b>NJK</b>	Të nxënit jashtë klase



### 3. Si mund të ju ndihmojë doracaku?



Doracaku i të nxënit në lidhje me mjedisin u ofron mësimdhënësve shkathtësi për qasje të reja të mësimdhënies për të zhvilluar shkathtësitë relevante të nxënësve për shekullin 21. Ai është i përshtatur për t'Ë mbështetur parimet dhe qasjet e reja të mishëruara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës. Për nga vet natyra e tij, ai i prek të gjitha lëndët dhe promovon të mësuarit e integruar, praktikat personale, punën me komunitetin dhe iniciativat e nxënësve.

Doracaku i paraqet të gjitha këto qasje përmes përvojave interesante të të nxënit brenda dhe jashtë klasës. Ky doracak u ndihmon mësimdhënësve t'Ë planifikojnë aktivitetet e veta të mësimdhënies lidhur me mjedisin, të ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit në shkollë, dhe të ndikojnë në komunitetin e vet.

Hulumtimet kanë treguar se një pako mjaft e thjeshtë e strategjive mund ta përmirësojë rrënjësisht të nxënit e nxënësve. Këto strategji përfshijnë: qëllimet e përbashkëta të orës së mësimit me nxënësit; ofrimin e një modeli të mirë të asaj se si duket sukcesi; zhvillimin e kreativitetit dhe të menduarit ndryshe; sfidat e dizajnit dhe zgjidhja e tyre; puna në grupe dhe zhvillimi i komunikimit; ndihma dhe përkrahja e njëri-tjetrit dhe inkurajimi i nxënësve për të ndërmarrë veprime dhe për të bërë ndryshime në zgjidhjen e problemeve mjedisore në komunitetin e tyre.


Kjo qasje i pajisë të rinjtë me njohuri, aftësi dhe të kuptuar për të luajtur një rol efektiv në jetën publike përmes shqetësimit për mirëqenien e mjedisit të tyre në aspektin lokal, kombëtar dhe global. Nxënësit inkurajohen që të interesohen për çështjet tematike dhe kundërtëhënës dhe që të angazhohen në diskutime dhe debate, të mësojnë për natyrën, dukuritë natyrore dhe ndikimin që ka njeriu në to. Ata mësojnë që të marrin pjesë në vendimmarrje dhe në forma të ndryshme të veprimit. Ata luajnë rol aktiv në jetën e tyre shkollore, në lagje, komunitete dhe në mbarë shoqërinë si qytetarë aktiv. Disa shkolla në Kosovë tashmë e kanë prezantuar qasjen e të nxënit lidhur me mjedisin (NLM). Këto shkolla janë pajisur me mjete dhe pajisje të nevojshme për të realizuar qasje të re në procesin e mësimdhënies. Janë trajnuar një numër mjaft i madh i mësimdhënësve. Këto dhe forma tjera të përkrahjes dëshmojnë përparime të konsiderueshme në mësimdhënie dhe në të nxënë. MASHT-i tani dëshiron të sigurohet që të gjitha shkollat të kenë qasje në ngritje dhe përkrahje profesionale të cilësisë së lartë në atë mënyrë që të nxënit lidhur me mjedisin (NLM) t'Ë njoftojë mësimdhënësit me mënyrat e reja të mësimdhënies dhe nxënies të cilat do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe sasisë së NLM-së nëpër shkolla.

#### **Të nxënit për mjedisin është i dobishëm për mësimdhënësit dhe nxënësit në disa mënyra të ndryshme:**

- Mësimdhënësit përfitojnë trajnim cilësor tregues me qasje të reja në të nxënit për mjedisin. Pos kësaj, nga po ky trajnim, përfitojnë edhe 20-34 orë sipas Sistemit të licencimit të MASHT-it.
- Nxënësit përfitojnë mundësi të angazhimit në të nxënë me aktivitete praktike, konkrete dhe tërheqëse mësimore.
- Shkollat përfitojnë nga angazhimi konstruktiv i nxënësve që rezulton nga kursi i të Nxënit për Mjedisin. Shkollat fitojnë gjithashtu pajisje për zbatimin më të lehtë dhe më të qëndrueshëm të të nxënit mbi mjedisin dhe aktivitete tërheqëse përmes themelimit të Klubeve të Gjelbra dhe involvimit të komunitetit në këto aktivitete.



## 4. Si ta përdorim doracakun?



Në fillim të këtij doracakut shpjegohet se kujt i është dedikuar ky doracak, si mund të ndihmojë, si ta përdorim doracakun dhe paraqitet tabela e shkathtësive të shekullit 21.

Kapitujt gjashtë dhe shtatë, shpjegojnë arsyen për një focus të ri, aktivitetet ekstrakurikulare, cilat janë mundësitë e reja dhe cilat janë benefitet.

Kapitujt tetë dhe nëntë paraqesin konceptin e ri me nxënësin në qendër, metodologjinë e re dhe mënyrën se si e gjithë kjo lidhet me kompetencat e MASHT-it. Poashtu këtu prezantohet qasja e re: fushatat, sfidat e dizajnit, kubet e gjelbra, etj.

Kapitulli i dhjetë paraqet metodat e reja të vlerësimit, kapitulli njëmbëdhjetë flet për rëndësinë e të mësuarit për ambientin në shkollë, kapitulli i dymbëdhjetë ndihmon për të krijuar portfolio e mësimdhënësit dhe poashtu në fund të librit kemi informata shpesh dhe referenca të ndryshme.



### 4.1 Legjenda



**Shembuj konkret apo tregime nga shkolla**



**Aktivitetet në klasë**



**Më rëndësi të madhe**



**Vegëzat e ndryshme p.sh. shiko fq x, referim në uebfaqe, etj.**



# SHKATHËSITË

## Basic Education Program

Përmes punës në grupe, nxënësit zhvillojnë shkathësitë e komunikimit, kreativitetin dhe e pranojnë mendimin e njëri tjetrit. Gjatë punës në grupe ata kuptojnë rolet e tyre në grup. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin përmes aktiviteteve konkrete.



të menduarit kritik



vetëvlerësimi



puna grupore



udhëheqësia

### KOMPETENCAT KRYESORE TË KURRIKULËS SË KOSOVËS

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE TË SHPREHURIT  
(Komunikues efektiv)

KOMPETENCA E TË MENDUARIT (Mendimtar kreativ)

KOMPETENCA E TË MËSUARIT (Nxënës i suksesshëm)

KOMPETENCA QË KA TË BËJË ME PUNËN, JETËN DHE MJEDISIN  
(Kontribues Produktiv)

KOMPETENCA PERSONALE (Individ i shëndoshë)

KOMPETENCA QYTETARE (Qytetar i përgjegjshëm)



të lexuarit



# E SHEKULLIT 21

Ata do të zhvillojnë ndërmarrësi, do të zhvillojnë dhe respektojnë oraret, dorëzimin e projekteve në kohë, do ta mësojnë procesin dhe rezultatet. Përdorimi i pajisjeve të shekullit 21 do t'u ndihmojë nxënësve të përgatiten për jetë dhe punë.

## SHKATHTËSITË RELEVANTE TË BASIC EDUCATION PROGRAM

### LEGJENDA

-  të menduarit kritik
-  vetëvlerësimi
-  puna grupore
-  të lexuarit
-  TIK-u
-  të zgjidhurit e problemit
-  kreativiteti
-  hulumtimi
-  ndërmarrësia
-  udhëheqësia
-  gjuha e huaj



TIK-u



të zgjidhurit e problemit



kreativiteti



ndërmarrësia




gjuha e huaj



hulumtimi

## 5. Si duket të nxënësit lidhur me mjedisin?



## 6. Pse na duhet fokusi i ri?



### **Sfidat të cilat janë krijuar për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndotjes së ambientit**

#### **Furnizimi me ujë**

Ndryshimet klimatike si dhe rritja e popullsisë do ta bëjnë furnizimin me ujë të freskët më sfidues në vitet e ardhshme. Një mënyrë për ta kursyer ujin është dieta vegjetariane. Të ushqyerit me proteina konsumon 10 herë më shumë ujë në krahasim me të ushqyerit vegjetarian. Një e treta e tokës së punuar në botë përdoret për të kultivuar ushqim për kafshët.

#### **Bujqësia**

Nryshimet në klimë, po i bëjnë viset e thata edhe më të thata, ndërsa viset e lagështa edhe më me lagështi, duke shkaktuar më shumë presion në bujqësi. Periudhat e thata do të jenë më të gjata, duke i bërë thatësitat më intensive, dhe reshjet do të jenë të rënda, duke e rritur rrezikun e përmytjeve.

#### **Problemet shëndetësore**

Ndryshimet në klimë ndikojnë që periudhat e nxehtësisë të jenë më të shpeshta, më të rënda, dhe më të gjata në verë, si dhe të ketë me pak periudha të ftohta në dimër. Një vlerësim shkencor i kohëve të fundit sugjeron se vdekjet e shkaktuara prej nxehtësisë do të jenë më të mëdha se vdekjet nga të ftohtit<sup>1</sup>. Periudhat e gjata të të nxehtëtit mund të çojnë deri tek sulmet e ndryshme dhe dehidrimi. Fëmijët e vegjël, të vjetrit, njerëzit me probleme shëndetësore dhe të varfërit janë më të rrezikuar nga sëmundjet që vinë nga nxehtësia.

Nxënësit fillojnë të kuptojnë se si kanë ndryshuar dhe si janë duke ndryshuar sistemet natyrore në Kosovë, Evropë dhe në mbarë botën. Të Nxënit Lidhur me Mjedisin i adreson çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë sociale, me të drejtat e njeriut, me komunitetin dhe me përgjegjësinë personale dhe ndërvarësinë globale dhe i inkurajon nxënësit që t'i kundërshtojnë padrejtësitë, pabarazitë dhe diskriminimin. Ai u ndihmon të rinjve që t'i zhvillojnë aftësitë e tyre kritike, të shqyrtojnë një varg problemesh politike, shoqërore, etike dhe morale, dhe t'i shqyrtojnë opinionet dhe idetë e të tjerëve. Ata i vlerësojnë informatat, gjykojnë në bazë të informatave të mira dhe mendojnë për pasojat që kanë veprimet e tyre tani dhe në të ardhmen. Ata mësojnë që të argumentojnë për një rast në emër të tyre dhe në emër të të tjerëve.

Kjo u ndihmon nxënësve që të informohen, të bëhen kritik, të bëhen qytetarë aktiv që kanë besim dhe që janë të bindur të bashkëpunojnë, të ndërmarrin veprime dhe të përpiqen t'i ndryshojnë gjërat në komunitetet e tyre dhe në mbarë botën.

<sup>1</sup> USGCRP (2009). *Global Climate Change Impacts in the United States*. Karl, T.R., J.M. Melillo, and T.C. Peterson (eds.). United States Global Change Research Program. Cambridge University Press, New York, NY, USA



**Përmes të nxëniet lidhur me mjedisin të rinjtë do të mësojnë që të:**

- Shqyrtojnë vendin e tyre në botën që po ndryshon, për të kuptuar se si veprimi i njeriut në një vend të caktuar ndikon në vendet e tjera
- Shqyrtojnë vlerat dhe përgjegjësitë e tyre në raport me njerëzit e tjerë, mjedisin dhe planetin e tyre
- Vlerësojnë në mënyrë kritike se çka thonë qeveritë, bizneset dhe individët, se çfarë janë duke bërë për të plotësuar nevojat e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme
- Të marrin parasysh nevojat e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme kur i bëjnë zgjedhjet e tyre
- Të mendojnë me imagjinatë rreth asaj se çka mund të bëjnë individët për të zhvilluar një shoqëri më të informuar dhe një të ardhme më të qëndrueshme
- Zbulojnë mënyra për të ndikuar në të tjerët, duke vepruar si agjentë të ndryshimit
- Kuptojnë sfidat globale afatgjate, përfshirë edhe ndryshimet klimatike, pabarazinë, varfërinë dhe zhvillimin, dhe t'i vlerësojnë mënyrat në të cilat këto çështje ndikojnë dhe e ndryshojnë shoqërinë


**Për t'i arritur këto rezultate nxënësit duhet të kenë mundësi që të:**

- Hulumtojnë dhe ndihmojnë në ruajtjen e mjedisit të tyre lokal
- Përdorin idetë e veta për të vepruar dhe për t'i kontribuar ndryshimit në mbarë komunitetin.
- Përdorin idetë e veta për të vepruar dhe për t'i kontribuar ndryshimit në shkollën e tyre
- Shqyrtojnë skenarët alternativ në të ardhmen për zgjedhjet e tyre
- Studiojnë dhe debatojnë pikëpamjet e ndryshme për sfidat me të cilat ballafaqohet shoqëria
- Rreziqet që lidhen me mosarritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të planetit Tokë
- Hetojnë se si bëhen ndryshimet mjedisore, përfshirë edhe studimin e ndikimit të aktivitetit të njeriut

## 6.1 Të nxëniet dhe ndërveprimi ndërkurrikular

Gjetja e “mundësive” për integrimin e çështjeve mjedisore si diçka që ka të bëjë me të gjitha lëndët mësimore është fokus i ri në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës. Qasja në mësimdhënien NLM në të gjitha lëndët mësimore është e dizajnuar që t’ua mundësojë të gjithë nxënësve ta kuptojnë mjedisin të lidhur me shkencën, artin, teknologjinë, edukatën qytetare, matematikën, etj. Nxënësit zhvillojnë një pikëpamje më koherente të NLM-së kur ata përjetojnë një kurrikulë të lëndës duke punuar bashkërisht për të arritur një kuptim të plotë të NLM-së.

Ai mund të përdoret edhe si kontekst stimulues për të mësuar në të gjitha lëndët, ai po ashtu mund të ofrojë një kontekst detyrues për zhvillimin e aftësive të shkrim-leximit, njohjes së numrave dhe aftësive të personelit për të dhënë mësim dhe për të menduar.



## 6.2 Çfarë mundësish sjellim ne

Gjetja e “mundësive” për integrimin e çështjeve mjedisore si diçka që ka të bëjë me të gjitha lëndët mësimore është fokus i ri në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës. Qasja në mësimdhënien NLM në të gjitha lëndët mësimore është e dizajnuar që t’ua mundësojë të gjithë nxënësve ta kuptojnë mjedisin të lidhur me shkencën, artin, teknologjinë, edukatën qytetare, matematikën, etj. Nxënësit zhvillojnë një pikëpamje më koherente të NLM-së kur ata përjetojnë një kurrikulë të lëndës duke punuar bashkërisht për të arritur një kuptim të plotë të NLM-së. Ai mund të përdoret edhe si kontekst stimulues për të mësuar në të gjitha lëndët, ai po ashtu mund të ofrojë një kontekst detyrues për zhvillimin e aftësive të shkrim-leximit, njohjes së numrave dhe aftësive të personelit për të dhënë mësim dhe për të menduar.

### Çfarë dobie ka kjo për palët e ndryshme të interesit?

- Nxënësit zhvillojnë aftësi bazike për jetë, për edukatë qytetare dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve, dhe për t’i kuptuar sistemet natyrore dhe shoqërore.
- Ofrohet mundësi që nxënësit të ndërveprojnë me pjesëtarët e komunitetit në një mjedis bashkëpunues
- Forcon aftësitë e tyre komunikuese dhe i kontribuon ekipeve që përpiqen të arrijnë qëllimin e përbashkët, si kur punojnë në mënyrë të pavarur ashtu dhe në grupe të përbashkëta.
- Ofron një kuptim më të mirë të marrëdhënieve të ndërlikuara në mes të komuniteteve dhe shoqërive
- Bashkëpunim më i ngushtë dhe punë ekipe kur nxënësve u kërkohet të zgjidhin probleme të cilat ata janë të interesuar t’i zgjidhin

## 7. Koncepti i ri

### 7.1 Fushëveprimi dhe përmbajtja e NLM-së

Fushëveprimi dhe përmbajtja e NLM-së siguron koherencën (ndërlidhjen) me kurrikulën e re të Kosovës. Kjo zhvillon kompetencat dhe përmbajtjen e re në mësimdhënie dhe të nxënësve aktiv, si dhe me pjesëmarrje dhe partneritet shkollë-komunitet. Qasja e re siguron që NLM-ja efektive në shkolla të fillojë me kurrikulën, të evoluojë me praktikën më të mirë në klasë, dhe në fund mos të kufizohet vetëm në shkollë por të shkojë përtej duke u lidhur me komunitetin. Integrimi i NLM-së në kurrikulë është jetik në adresimin e këtyre qëllimeve dhe parimeve për të krijuar nxënës të suksesshëm, individë me vetëbesim dhe qytetarë të përgjegjshëm.



Të Nxënësve Lidhur me Mjedisin promovon integrimin përtej fushave të disiplinave (atë ndërdisiplinar) dhe ofron kontekstin e të nxënësve. Ai e plotëson dhe e mbështetë qasjen e re përmes ofrimit të mundësive për mësim praktik dhe u jep nxënësve mundësi t'i aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në zgjidhjen e problemeve në botën reale. Kjo është një ndër mënyrat më efektive për t'i motivuar nxënësit, për ta nxitur kureshtjen e tyre dhe për t'i fuqizuar ata për ta ndryshuar botën. (Referencat në "Edukimi Mjedisor në Veprim")

Edukimi i suksesshëm për të nxënësve lidhur me mjedisin nënkupton format dhe metodat e hapura të të nxënësve të orientuara kah nxënësit. Të nxënësve të tillë duhet të jetë ndërveprues dhe praktik, në mënyrë që të sigurohet që praktika të jetë gjerësisht e përhapur dhe e shumëfishtë në radhët e nxënësve. Si e tillë, ajo po ashtu motivon nxënësit që të jenë aktiv, por edhe zhvillon ndjenjën e tyre për komunitetin përmes forcimit të aftësive dhe atmosferës së punës ekipore dhe përmes përkushtimit të shoqërisë në përgjithësi.

## 7.2 Roli i nxënësve dhe mësimdhënësve dhe komunitetit

### Nxënësit

Nxënësit e kanë entuziazmin dhe vëmendjen për të mësuar gjëra të reja dhe të marrin rol udhëheqës në mbrojtjen e mjedisit, ata mund të iniciojnë ndryshime për shpërndarjen e vetëdijesimit mbi çështjet e mjedisit, të identifikojnë indikatorët kryesorë për një mjedis të shëndoshë, të identifikojnë dhe qartësojnë një problem, çështje, apo pyetje, të zbatojnë strategji për t'i adresuar problemet e mjedisit dhe të përgatisin zgjidhje, të demonstrojnë gatishmëri për të punuar me të tjerët drejt një qëllimi të përbashkët për një mjedis më të sigurtë.

Nxënësit duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në programe mjedisore të cilat janë thelbësore për mbrojtjen e planetit Tokë. Ata mund të përfitojnë nga të nxënit e vërtetë mbi botën dhe zhvillimin e shkathtësive ndërmarrësore dhe menaxheriale.

### Mësimdhënësit

Mësimdhënësit mund të luajnë rol të rëndësishëm në edukimin mbi mjedisin. Ata mund t'u ofrojnë nxënësve fakte që të mund të lëvizin nga vetëdijesimi në veprim, t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre të mendimit kritik si zgjidhja e problemeve apo vendimmarrja që mund t'u ndihmojë t'i kuptojnë dhe të merren me probleme.

Mësimdhënësit mund t'i zhvillojnë shkathtësitë relevante përmes NLM-së tek nxënësit e tyre me anë të aktiviteteve të vazhdueshme, ata mund ta rrisin vetëdijesimin rreth çështjeve dhe të kuptuarit e vlerave personale duke gërmuar në qëndrimet dhe besimet dhe duke u ndihmuar nxënësve të vlerësojnë dhe t'i qartësojnë ndjenjat e tyre rreth mjedisit dhe mënyrës si mund t'i kontribuojnë problemeve mjedisore. Ata mund t'i nxjerrin nxënësit në natyrë dhe ta sjellin natyrën në klasë si dhe të ofrojnë edukim praktik mbi mjedisin.

### Komuniteti

Prindërit dhe komuniteti mund t'i përkrahin qëllimet e mjedisit të shkollës duke modeluar sjellje në shtëpi dhe duke i përkrahur projektet e mjedisit në shkollë.

Shkollat duhet të ndërtojnë përkrahje të gjerë të komunitetit, përmes angazhimit aktiv në aktivitete shkollore dhe punës së përbashkët për shkëmbimin e njohurive dhe informatave dhe pjesëmarrje në veprime që kanë të bëjnë me përmirësimet e mjedisit, shkëmbimit të burimeve themelore – duke përfshirë edhe burimet materiale e edhe ato njerëzore dhe krijimit të vetëdijes për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi.

Këto aktivitete të përbashkëta mund të ndihmojnë edhe për zhvillimin e ndjenjës së komunitetit përmes fuqizimit të sjelljeve dhe ndjenjës së ekipit dhe atë të përkushtimit ndaj shoqërisë si tërësi.

Shkollat dhe komunitetet kontribuojnë në arritjen e rezultateve më të mira për qëndrim pozitiv ndaj mjedisit, mbrojtjes së tij, ruajtjes dhe konservimit. Këto gjëra duhet të promovohen në mënyra efektive përmes përfshirjes së shkollës, prindërve dhe komuniteteve.



## 8. Metodologjia e Re

### 8.1 Parimet e Përgjithshme



Metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies së koncepteve, problemeve dhe çështjeve lidhur me mjedisin është diçka krejtësisht e re në Kosovë. Shumë nga metodat e ndryshme të përdorura në këtë rast janë praktikisht të njëjta si ato që përdoren edhe në fushat e lëndëve të tjera. Megjithatë, meqenëse objektivat e edukimit mjedisor kërkojnë rezultate më sfiduese të nxënies, praktikat ekzistuese në klasë kanë nevojë të plotësohen me teknika më inovative dhe pjesëmarrëse.

#### Rezultatet kryesore të të Nxënit Lidhur me Mjedisin janë:

*I. Përmirësimi i vetëdijësimit lidhur me shqetësimet mjedisore*

*II. Zhvillimi i të kuptuarit të parimeve ekologjike*

*III. Rritja e interesimit për problemet mjedisore*

*IV. Stimulimi i zotimeve për mbrojtjen e mjedisit*

*V. Pretendimi i veprimeve për promovimin e ruajtjes së burimeve natyrore*

I tërë procesi përfshin një gamë të gjerë mësimesh për vetëdijësimin dhe të kuptuarit, ndjeshmërinë, shqetësimin, zgjedhjet e përgjegjshme, vullnetin dhe zotimet për veprim. Të gjitha këto mësimë, natyrisht, nuk mund të ofrohen përmes një burimi apo një metode të vetme. Mësimdhënësi duhet të shfrytëzojë një sërë burimesh mësimore dhe të përdorë teknika të shumta, të veçanta apo të kombinuara, për t'i çuar nxënësit më afër synimeve të caktuara.

#### Nevoja për përdorimin e më shumë metodave dhe teknikave inovative shtohet sepse:

- *Ajo që po mësohet shkon shumë përtej të mësuarit të lëndëve tradicionale*
- *Mësimdhënësi duhet të arrijë më shumë objektiva sfiduese të ndryshimit të qëndrimeve, zhvillimit të shkathtësive, ngritjes së shqetësimeve, marrjes së zotimeve, qartësimin të vlerave dhe sigurimit të pjesëmarrjes dhe veprimeve nga ana e nxënësve.*



### 8.1.1 Lidhja me kompetencat e MASHT-it

MASHT i ka hartuar kompetencat kyçe në kuadër të Kurrikulës së Kosovës, dhe projekti ka identifikuar lidhjen mes kompetencave dhe shkathtësive relevante. Tabela në vijim nënvizon kompetencat e MASHT-it dhe shkathtësitë të cilat lidhen me aktivitetet e NLM-së në procesin e trajnimit.

Siç tregon edhe tabela e mëposhtme, aktivitetet e NLM-së do t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë shkathtësi dhe kompetenca relevante si të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, prezantimin, të dëgjuarit aktiv, kreativitetin dhe punën ekipore, që duhen për të bërë dallimin në përmirësimin e mjedisit në shkollën dhe komunitetin e tyre. Të gjitha këto aktivitete prezantojnë qasje të reja përmes përvojave mësimore të përzistueshme si në klasë, ashtu edhe jashtë saj. Ato zhvillohen nga mësimdhënësit dhe nxënësit dhe fokusohen në zhvillimin e nxënësve si komunikues efektiv, mendimtarë kritik, individë të shëndetshëm dhe qytetarë të përgjegjshëm në ambientin ku jetojnë. Të gjitha aktivitetet (shtylla 3 poshtë) janë në përputhje me kompetencat e MASHT-it dhe shkathtësitë parësore dhe synojnë t'i përmbushin ato.



## 8.1.2 Karakteristikat

**Problemet mjedisore mund të ndërlidhen edhe me metodologjitë e reja të mësimdhënies si në vijim:**

- *Kërkimi / Hulumtimi*
- *Mendimi kritik*
- *Bashkëpunimi*
- *Të nxënit konstruktiv*
- *Hulumtimi në veprim*

### Kërkimi/Hulumtimi


Kur flasim për hulumtime në këtë doracak përpiqemi t'i përshkruajmë metodat për hulumtimin në grup të të nxënit kolektiv. Rëndësia e përkrahjes së dijeve në grup dhe zhvillimit të tyre në grup nuk është ide e re. Hulumtimi mbështet zhvillimin e përvojave të të nxënit kur nxënësit i vëzhgojnë ngjarjet, bëjnë pyetje, formulojnë shpjegime, i testojnë ato shpjegime, mendojnë në mënyrë logjike dhe kritike, i përgjithësojnë modelet e vëzhguara, dhe analizojnë shpjegime alternative. Në këtë proces ciklik, nxënësi bën pyetje. Këto pyetje çojnë drejt dëshirës për përgjigje në pyetje (apo zgjidhje të problemeve) dhe rezultojnë në fillimin e eksplorimit dhe krijimin e hipotezave. Këto hipoteza çojnë drejt hulumtimit për testimin e tyre apo gjetjen e përgjigjeve dhe zgjidhjeve për pyetjet dhe/ose problemet.

Hulumtimet çojnë drejt krijimit apo ndërtimit të dijeve të reja bazuar mbi gjetjet e hulumtimeve. Nxënësi diskuton dhe reflekton mbi këto dije të sapozbuluara, çka sjellë pyetje të reja dhe hulumtime të mëtejshme. Kështu, reflektimi është cikli i fundit në procesin kërkimor. Një nga tiparet e rëndësishme të NPM/NLM duket se është praktika reflektive. Reflektimi sjellë ndërgjegjësim më të lartë tek nxënësit dhe mësimdhënësit lidhur me ato që përbëjnë praktikatat më të përshtatshme pedagogjike dhe ndërton themelet për zhvillim, një proces i cili do të vazhdojë pa ndalur përgjatë karrierës së tyre në arsim.


### Kjo qasje ndërton/krijon:

- *Motivim për të nxënë*
- *Siguron që të nxënit të jetë relevant*
- *Është në përputhje me parimet e pjesëmarrjes*
- *Është në përputhje me shkathtësitë e Basic Education Program dhe kompetencat e KKK-së*

Në skemën e mëposhtme paraqitet Korniza e Hulumtimeve/Kërkimeve.



### Korniza e Hulumtit



### Vlerësimi

**Çfarë na ka mësuar kjo përvojë?**

**Si e dimë? A e ka ndryshuar të menduarit tonë dhe, nëse po, si?**

*P.sh. përmes aktiviteteve të vetvlerësimit dhe vlerësimit të ndërsjellë mes kolegëve.*

**Çfarë pyetjesh të tjera kemi?**

**Çka më tej?**

### Komunikimi

*Çfarë të bëjmë me këto dije?*

**Kujt t'ia tregojmë dhe si?**

**Për shembull:**

*Informata kthyesë dhënë njëri-tjetrit, në klasë, në shkollë, në faqen e internetit, prezantime në klasët tjera, në mbledhje, në letrat informuese për prindërit, letra dërguar organeve të shtypit vendor, Kryeministrit, ekspozita, etj.*

## Të menduarit kritik

Synimi parësor i hartimit të këtij doracaku është trajnimi i mësimeve për të menduar lidhur me problemet mjedisore të reja apo të panjohura.

Temat e veçanta që kemi përdorur për ilustrimin e shkathtësive të të menduarit që dëshirojmë t'i zhvillojmë janë të dorës së dytë; në fakt, ne inkurajojmë mësimeve dhe nxënësit të gjejnë kundërthënie (kontradikta) vendore në aspekt të mjedisit ku mund të shfrytëzohen shkathtësi të ngjashme të të menduarit, dhe jo të mbështeten aq shumë në shembujt që përmendim këtu. Shkencëtarët e fushës së mjedisit – si dhe individ laik që merren me çështje ambientaliste – mbështeten kryesisht në një instrument relativisht të vogël shkathtësish të menduarit kritik. Këto shkathtësi mund t'u mësohen në mënyrë progresive jo vetëm nxënësve që i njohin mirë shkencat, por edhe nxënësve me pak njohuri apo trajnim në fushat e shkencave.

Të menduarit kritik është shkathtësi që mund të mësohet. Megjithatë, disiplina të ndryshme kanë tradita të ndryshme lidhur me elementet e të menduarit të saktë kritik. Për shkak se çështjet mjedisore, nga natyra, ngërthejnë disiplina të ndryshme, këtu mund të shfrytëzohet dobishëm një gamë e gjerë e qasjeve të mendimit kritik lidhur me çështjet mjedisore. Nëse shqyrtojmë problemet e ndryshmeve klimatike globale, për shembull, ato mund të analizohen nga këndvështrime të ndryshme, përfshirë (mes të tjerash):

- Ekonomike (strategji menaxhimi për kostot e jashtme, kursimin e kohës, efektivitetin e kostos apo strategji alternative),
- Politike (menaxhimi i pronës së përbashkët, organizatat ndërkombëtare, politikat e grupeve të interesit, qeverisja globale),
- Historike (Si ka ndikuar marrëdhënia e ngushtë mes qeverisë dhe industrisë në ndërtimin e një ekonomie që emeton kaq shumë karbon? A është keqësuar gjendja e përdorimit të karbonit si pasojë e besimit të modernistëve në përparimin material? Si lidhen konfliktet politike dhe neokolonializmi i shekullit 20 me emetimet e karbonit?),
- Shkencore (Si shpie CO<sub>2</sub> tek ngrohja globale? Sa CO<sub>2</sub> po shkarkohet? Si mund ta ndryshojë klimën globale një ekuilibër i ndryshuar i energjisë?).

Praktikisht, çështjet mjedisore janë mjaft komplekse, dhe shpesh është me vend të mendohet për to nga këndvështrime të shumëfishta. Secili këndvështrim i ka përparësitë e veta, dhe hap rrugën për të kuptuar gjëra që nuk qartësohen kur shihen nga këndvështrime të tjera.

Sidoqoftë, detyra jonë me këtë material është më e ngushtë. Thjesht duam t'u japim mësimeve mundësinë t'i ushtrojnë nxënësit e tyre që të mendojnë në mënyrë kritike lidhur me çështjet e mjedisit nga pikëpamja teknike apo shkencore. Qasjet e tjera janë po ashtu të vlefshme, dhe ne nuk kemi për qëllim t'i konsiderojmë më pak të rëndësishme duke mos i përmendur. Ato thjesht nuk janë tema e këtij materiali.

## Bashkëpunimi

Të nxënit bashkëpunues është një situatë ku dy apo më shumë individë mësojnë ose përpiqen të mësojnë diçka së bashku. Meqenëse dija nuk mund të transmetohet por ndërtohet në mënyrë aktive, mësimeve duhet të krijojnë situata që përmbajnë përvoja të interpretueshme.




Nxënësit mësojnë posaçërisht mirë kur angazhohen aktivisht në gjetjen dhe ndërtimin e dijeve në situata duke-bërë-duke-mësuar (bëj-pa-mësoj).



### Të nxënit konstruktiv

Reformat në arsim, në shumë vende përfshirë edhe Kosovën, zakonisht kanë nxitur ndryshime nga situata "mësimdhënësi në qendër" orientuar kah të nxënit në ambiente mësimore konstruktiviste me nxënësin në qendër. Sipas pikëpamjes konstruktiviste të mësimit, nxënësit e ndërtojnë vet të kuptuarit e tyre për përmbajtjen e hulumtimeve. Për t'a arritur këtë, atyre u duhet një ambient mësimor që mbështet hulumtimin, analizën, reflektimin dhe zbulimin. Pikëpamja konstruktiviste bazohet në parakushtin që ne të gjithë i ndërtojmë vet mendimet tona mbi botën rreth nesh, përmes integritit të përvojave tona individuale dhe skemave tona të kombinuara me dije të reja. Prandaj, Konstruktivizmi fokusohet në përgatitjen e nxënësit për të zgjidhur probleme në situata që karakterizohen nga dykuptimësia. Nga aspekti konstruktivist, dija nuk është e pavarur nga njohësi i asaj dije (pra ai që e njeh këtë dije); dija përgjithësisht konsiston në objektet fizike dhe ato abstrakte në eksperiencën tonë.



Shënime:

---



---



---



---



## Konstruktivizmi në klasë


Një ambient mësimor konstruktivist dallon shumë nga një ambient mësimor tradicional. Në klasën konstruktiviste, mësimdhënësi bëhet udhërrëfyes i nxënësit, ai siguron skeletin apo urat lidhëse, ndihmon zgjerimin e zonës së afërt të zhvillimit të nxënësit. Nxënësi inkurajohet që t'i zhvillojë shkathtësitë metakognitive siç janë të menduarit kritik dhe teknikat e zgjidhjes së problemeve. Nxënësi i pavarur është vetvetiu i motivuar për të gjeneruar, zbuluar, ndërtuar dhe zmadhuar kornizën e dijeve (njohurive) të tij.

Brooks & Brooks (1993) ofron një krahasim interesant të dallimeve të dukshme në mes të klasës konstruktiviste dhe asaj tradicionale: (Referenca "Doracaku për Klasën e Shekullit 21")

<i>Klasa Tradicionale</i>	<i>Klasa Konstruktiviste</i>
Nxënësit punojnë kryesisht vetëm.	Nxënësit punojnë kryesisht në grupe.
Kurrikula paraqitet nga pjesa tek e tëra, me theks tek shkathtësitë bazë (nga poshtë lart).	Kurrikula paraqitet nga e tëra tek pjesa, me theks tek koncepti i madh (nga lart poshtë).
Vlerësohet lartë mos-devijimi nga një kurrikulë e fiksuar.	Vlerësohen shumë pyetjet që vijnë nga nxënësit.
Aktivitetet kurrikulare mbështeten fuqimisht tek librat e mbushur me të dhëna dhe materiale manipuluese.	Aktivitetet kurrikulare mbështeten fuqimisht në burime të dorës së parë.
Nxënësit shihen si "pllaka të zbrazëta" mbi të cilat mësimdhënësit gdhendin informata.	Nxënësit shihen si mendimtarë me teori të reja mbi botën.
Mësimdhënësit kanë përgjithësisht sjellje didaktike, duke shpërndarë informacione tek nxënësit.	Mësimdhënësit kanë përgjithësisht sjellje ndërvepruese duke negociuar ambientin e diskutimeve për nxënësit.
Mësimdhënësit kërkojnë përgjigje të sakta për ta vlerësuar mësimin nga nxënësit.	Mësimdhënësit kërkojnë t'i dinë pikëpamjet e nxënësve.
Vlerësimi i nxënies nga ana e nxënësit shihet si i ndarë nga mësimdhënësia dhe zhvillohet pothuajse krejtësisht përmes testimit.	Vlerësimi i nxënies nga ana e nxënësit është i gërshetuar me mësimdhënien dhe zhvillohet përmes vëzhgimit të nxënësit nga mësimdhënësi gjatë punës dhe përmes ekspozitave dhe portfolios (dosjes).

## 8.2 Ilustrim i strategjive të reja mësimore: Hulumtimi në veprim

Edukimi mjedisor ka për qëllim t'i zgjerojë njohuritë e nxënësve lidhur me mjedisin, t'i sfidojë qëndrimet dhe sjelljet që formojnë bazën e qytetarisë ambientaliste dhe t'i zhvillojë shkathtësitë për t'u mundësuar atyre ndërmarrjen e veprimeve për mjedisin.



Hulumtimi në Veprim (HV) është një ide që mund ta zbatoni për ta përmirësuar praktikën tuaj mësimdhënëse, si dhe aspekte të tjera të punës akademike si hartimi i kurrikulës dhe vlerësimi i kursit. Hulumtimi në veprim, apo hulumtimi praktik siç quhet nganjëherë, është një formë e kërkimit shkencor të aplikuar që ndihmon ndryshimin e praktikave të mësimdhënies dhe nxënies aty ku mësimdhënësi është faktikisht hulumtuesi. Ideja e veprimit hulumtues mbetet një mjet i fuqishëm për përmirësimin e praktikave në çdo ambient arsimor. Për edukatorët e fushës së mjedisit, Hulumtimi në veprim premtan progres drejt profesionalizimit. Procesi i lejon ata ta provojnë zgjidhjen e problemit dhe ta japin shembullin për nxënësit e tyre.

Mësimdhënësit duhet ta kenë mundësinë që të zgjedhin të punojnë me modele të ndryshme të veprimit hulumtues, por ata duhet të përshkruajnë probleme të ndryshme mjedisore duke përdorur modelin me tri faza: gjetja e pikës së fillimit dhe qartësimi i situatës; hartimi i strategjive të veprimit dhe analizës; dhe dalja me një teori.

Në thelb, hulumtimi në veprim nuk promovohet si metodë për nxënësit e shkollës së mesme të ulët por si mënyrë në të cilën profesionistët (përfshirë mësimdhënësit) përmirësojnë praktikën e tyre. Është një proces i vazhdueshëm ku profesionistët reflektojnë mbi praktikën e tyre dhe marrin hapa drejt përmirësimit të tyre. Shpesh, hulumtimi në veprim është bashkëpunues dhe mësimdhënësit punojnë së bashku në planifikimin e aktiviteteve dhe krahasimin e gjetjeve.

### Pse hulumtimi në veprim ndryshon nga ngritja profesionale tradicionale?

Ngritja profesionale tradicionale	Hulumtimi në veprim
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënësit trajnohen dhe prej tyre pritet që t'i zbatojnë njohuritë e trajnimit në klasë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënësit reflektojnë mbi praktikën dhe punën e tyre në mënyrë që të përmirësohen</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënësit pritet t'i zbatojnë reformat në formë të izoluar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënësit punojnë së bashku për ta përmirësuar mësimdhënien e tyre</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënësve u jepen informata</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënësit i marrin përsipër vetë hulumtimet e tyre</li> </ul>

(Referenca "Doracaku për Klasën e Shekullit 21")

## 9. Qasja e re

Qasjet e reja janë si në vijim

- *Fushata*
- *Sfidat e dizajnit*
- *Klubet e gjelbra*

### 9.1 Fushata



*Doracaku i fushatës është një instrument i mësimit dhe nxënësit për organizimin e fushatave në kuadër të shkollës.*

*Ky instrument shërben për vetëdijësimin dhe mobilizimin e shkollës dhe komunitetit për realizimin e projekteve konkrete përmes Klubeve të Gjelbra.*

**Hapat që duhet ndjekur në këtë instrument janë si më poshtë:**

#### **Hapi 1:**

CILA është kauza për të cilën doni të bëni fushatë? Në këtë periudhë është shumë me rëndësi që të bëhet identifikimi i çështjes për të cilën doni të bëni fushatë. Fillimisht propozohen disa çështje të cilat mendohet se mund të kenë rëndësi të veçantë për shkollën tuaj. Pastaj, merret mendimi i të gjithë atyre që kanë dalur me propozime, dhe vendoset për çështjen e cila ka më shumë argumente relevante dhe e cila mund të zhvillohet më konkretisht në shkollë.



#### **Hapi 2:**

KUSH e ka pushtetin për ta zgjidhur këtë çështje?

Në këtë periudhë bisedohet me nxënësit që të identifikohen aktorët relevantë të cilët do të kontribuonin në realizimin e fushatës. Këtu mund të hyjnë filluar nga komuniteti me prindërit e deri tek komunat dhe OJQ- të e ndryshme.

**Hapi 3:**

Si mund t'i bindni njerëzit e pushtetshëm për të dhënë përgjigje?

Në këtë periudhë përgatiten nxënësit për mënyrat e ndryshme të sensibilizimit të çështjes së fushatës së identifikuar përmes: debateve të hapura së pari në takimet me prindër e pastaj edhe me aktorë të tjerë, përgatitja e fletushkave, faqja e internetit, inkorporimi i mediave lokale, etj.

**Hapi 4:**

Ku është plani i fushatës suaj?

Në këtë periudhë nxënësit duhet të përgatiten për planifikimin e saktë të realizimit të fushatës, si p.sh. periodha kohore kur do të bëhet fushata, mjetet e nevojshme për realizimin e kësaj fushate, kush do të përfshihet në fushatë, etj.

**Hapi 5:**

ÇFARË keni mësuar nga fushata?

Në këtë periudhë është shumë me rëndësi të bëhet vlerësimi i brendshëm ose vetëvlerësimi i tërë procesit të fushatës. Kjo ka shumë ndikim në organizimin e fushatave të ardhshme dhe në motivimin e punës së nxënësve.

>> Udhëzimin e plotë të fushatës e gjeni të bashkangjitur në fund të këtij doracaku.

## 9.2 Sfidat e dizajnit

Projekti i dizajnit është një lloj projekti ku nxënësit angazhohen në procesin e dizajnit për të zgjidhur një problem autentik, relevant të jetës së përditshme. Ekipet e nxënësve aplikojnë dhe i thellojnë njohuritë e tyre në mjedis, teknologji dhe shkenca si dhe në matematikë, lëndë shoqërore dhe lëndë gjuhësore, përmes një procesi të hapur që rezulton në zgjidhje origjinale.



### Cilat janë përfitimet e qasjes së Sfidës së Dizajnit?

*Përmes procesit të Sfidës së Dizajnit, nxënësit kanë mundësi:*

- *Të ndërtojnë shkathtësi të gjera, të dobishme për jetën, pavarësisht nga specifikat e sfidës;*
- *Duke përdorur qasjen e hapur që çon drejt krijimit të dizajneve të shumta, nxënësit sfidohen t'i aplikojnë njohuritë e tyre në fushën përkatëse, përvojat e tyre, interesat dhe talentet e tyre në procesin e krijimit të një zgjidhjeje të re në frymën e ekipit;*
- *Kjo qasje formon një përvojë mësimore të jashtëzakonshme, ku nxënësit frymëzohen së tepërmi për të mësuar dhe fitojnë krenarinë e arritjes së qëllimit si grup.*



## SFIDA E SHTYPËSIT TË SHISHEVE DHE SHPORTËS SË RICIKLIMIT

Qëllimi i këtij aktiviteti është të motivohen nxënësit e shkollave që të punojnë për dizajnimin e një shtypësi të shisheve dhe një shporte për riciklim përmes një procesi pjesëmarrës shkollor, dhe këto pajisje të punohen nga prodhues të vegjël vendor (si dhe nga shkolla profesionale).



Qëllim tjetër njëkohësisht është edhe bashkimi i dy fushave të të nxënit nga kurrikula, të cilat janë teknologjia dhe mjedisi, për t'i ndihmuar nxënësit që ta kuptojnë domethënien e të nxënit të tyre në mënyrë që ta çmojnë më shumë faktin që lëndët shkollore ndërliken me çështje shoqërore dhe mënyrën se si nxënësit mund t'i kthejnë mësimet në veprime. Një pjesë e rëndësishme e kësaj iniciative është edhe ndërlihdja në mes të lëndëve dhe nismave të ndryshme në shkollë.

Për t'a arritur këtë, një numër i madh mesimdhënësish kanë ndjekur punëtoritë në fushën e Teknologjisë dhe në fushën e Të Nxënit Lidhur me Mjedisin (NLM) në kuadër të Basic Education Program në vazhden e implementimit të programeve për ngritjen profesionale të mesimdhënësve. Po ashtu, një numër i konsiderueshëm mesimdhënësish dhe nxënësish kanë pasur mundësinë të punojnë me sfida të dizajnit në punëtorinë "Vajzat dhe Teknologjia: Pse Jo?" e organizuar nga Programi.

Kështu, një numër i madh i mesimdhënësve janë përfshirë në aktivitete të ndryshme në fushën e NLM-së apo në përdorimin e teknologjisë arsimore dhe në të nxënit përmes sfidave të dizajnit si qasje e re. Kjo i bën ata edhe më të aftë për t'u angazhuar në aktivitete konkrete ku zgjidhen probleme reale të jetës së përditshme të cilat sjellin ndryshime pozitive në jetën dhe punën e tyre.

Më konkretisht, këta mesimdhënës do t'i organizojnë nxënësit e tyre në grupe në mënyrë që nxënësit të dalin me një dizajn për një Shtypës të Shisheve dhe një Shportë Riciklimi. Pas kësaj shkolla do të zgjedhë pesë propozimet më të mira dhe do t'ia paraqesë ato komisionit të vlerësimit (i përbërë nga disa aktorë dhe palë vendimmarrëse) i cili do të bëjë përzgjedhjen përfundimtare të punimeve më të mira.

Më pas, këto punime do të tenderohen për prodhim nga bizneset vendore, duke mundësuar kështu të investohet në shkathtësitë e prodhuesve vendor, të cilët njëkohësisht mund të bëhen pjesë e një bashkëpunimi me shkollat në kuadër të mësimet të teknologjisë. Shtypësit dhe Shportat e dizajnuara dhe të prodhuara do të shërbejnë si modele për shkollat dhe komunat tjera. Do të nënshkruhen Memorandume Mirëkuptimi jo vetëm me komunat, por edhe me ndërmarrjet e përfshira në prodhimin apo përdorimin e materialeve plastike në aktivitetet e tyre të biznesit. Këto partneritete do ta shtrojnë rrugën për fillimin e iniciativave shkollore drejt të

nxënit, drejt aplikimit/zbatimit, drejt prodhimit, dhe përfundimisht drejt qyteteve dhe fshatrave më të pastra në Kosovë.

### Qëllimet kryesore janë:

- *Të vendosen lidhjet në mes të teorisë së Të Nxënit Lidhur me Mjedisin (NLM) dhe jetës së përditshme;*
- *Të motivohen shkollat për t'u angazhuar në një formë të menduari dhe të vepruari më të qëndrueshme të karakterit sipërmarrës në lidhje me çështjet e mjedisit, si dhe në lidhje me zgjidhjen e problemeve praktike; dhe*
- *Të bëhet gërshetimi i teknologjisë (sfida e dizajnit) me NLM, që janë dy fusha parësore të Programit tonë.*

Mësimdhënësit e shkollave që kanë marrë pjesë në programet për Ngritjen Profesionale të Mësimdhënësve në Teknologji dhe NLM do të përfitojnë shkathtësi dhe njohuri të mëtejshme për të dhënë kontributin e tyre në një punë të tillë.

### Metodologjia e punës së sfidës së dizajnit:



**Modeli i sfidës së dizajnit  
“Shtypësi i shisheve të plastikës  
dhe kanaqeve” dhe  
“Shporta për riciklim”**



## Udhëzues për metodologjinë e punës

### Aktiviteti në klasë

Për klasat: 7-8-9



#### Qëllimi –Objektiva

Qëllimi i këtij aktiviteti është që t'u ndihmohet nxënësve që ta kuptojnë rolin dhe funksionin e disa makinave të thjeshta, si dhe përmes mjeteve të tyre të punës të dizajnojnë makina të tilla për nevojat e tyre ose të shkollës ku ata mësojnë.



#### Përshkrimi i aktivitetit

Nxënësit ndahen në grupe; secili grup duhet të jetë i përzier me nxënës të klasave 7, 8, dhe 9. Në grupe duhet të merret parasysh edhe struktura gjinore. Grupet do të dizajnojnë makina për shtypjen e shisheve të plastikës dhe kanaqeve si dhe shportat për riciklim. Këto punime do të ekspozohen në shkollë. Nga punimet e realizuara, shkolla do t'i përzgjedhë pesë më të mirat, varësisht nga organizimi mund të përzgjedhen nga ndonjë panel i nivelit më të lartë komunal ose nacional.

#### Materiali i nevojshëm për punë


- Çekan
- Laps
- Ngjyra
- Gërshërë
- Ngjytës letre (mund të jenë edhe dy lloje!!)
- Kapëse letrash
- Vizore etj.

#### Fjalët kyçe

Riciklimi

Ngjeshje

Shtypje etj.



#### Kohëzgjatja e aktivitetit

Varësisht nga puna e grupit, orës mësimore nga lënda e TIK-ut dhe lëndëve të tjera, ky aktivitet duhet mesatarisht të përfshijë 3-5 orë pune. Koha për dorëzimin e punimit është afërsisht 10 ditë nga dita e parë informuese.

#### Shkathtësitë e mësuara

Hulumtimi

Llogaritja, njësimi

Shkathtësitë motorike, etj.

## Metodologjia e punës

### Hapi 1:

Para se të fillohet me punën rreth aktivitetit ua shpërndani nxënësve materialet e nevojshme për punë të përshkruara më lartë. Së bashku me drejtorin e shkollës sigurohuni që nxënësit të kenë një hapësirë të përshtatshme për punën e tyre si klasë mësimi, kabinet pune etj.

### Hapi 2:

Në fillim ua prezantoni nxënësve konceptin e makinave të thjeshta, procesin e riciklimit etj. Gjithashtu bëni një ndërlidhje se si makinat e thjeshta janë kyçur në përdorim në procesin e riciklimit. Si p.sh. një lehtësim në procesin e riciklimit është ndarja dhe sortimi i mbeturinave si dhe përdorimi i makinave që e bëjnë shtypjen e shisheve të plastikës dhe kanaqeve me qëllim të zvogëlimit të vëllimit.

### Hapi 3:

Vendosni disa kanaqe alumini dhe shishe plastike në dysheme të klasës. Kërkoni ndonjë vullnetar që me këmbë ta bëjë shtypjen e këtyre kanaqeve dhe shisheve plastike. Kërkoni nga nxënësit që të identifikojnë se çka ndodhë pasi që kanaqet dhe shishet plastike të shtypen. Ata duhet të përshkruajnë se si me shtypje do të zvogëlohet madhësia e tyre, dhe kështu është më e lehtë të barten , transportohen etj.

### Hapi 4:

Kërkoni nga nxënësit që të reflektojnë se si do ta dizajnonin një makinë të thjeshtë për shtypjen e kanaqeve dhe shisheve të plastikës, makinë të cilën do ta përdornin për nevojat e shkollës së tyre. Gjithashtu kërkoni nga ata që të reflektojnë edhe në dizajnimin e shportës për ndarjen e mbeturinave.

### Hapi 5:

I njoftoni nxënësit se ky projekt fillimisht nisët nga faza e dizajnit, pra ata duhet ta dizajnojnë një makinë të thjeshtë për shtypje të kanaqeve dhe shisheve plastike dhe shportë për riciklim. Gjatë kësaj faze duhet që të bëhen të gjitha matjet, vizatimet skicat në mënyrë që të arrihet deri tek një produkt final. Gjatë punës së tyre nxënësit duhet të përshkruajnë se me çfarë materiali mendojnë ta ndërtojnë makinën e tyre, çfarë madhësie duhet ta ketë ajo, etj. Inkurajoni nxënësit që të jenë sa më të saktë në përshkrimin e të gjitha detajeve, dhe qëndroni pranë tyre që t'u ofroni çfarëdo ndihme që ata kanë nevojë.

### Hapi 6:

Rishikoni të gjitha punimet e nxënësve, sigurohuni që ato janë mirë të përshkruara me të gjitha fazat e punës, dhe kërkoni nga nxënësit që të shpjegojnë se si mendojnë ata që makina do të funksionojë ose se si do të duket shporta.

### Hapi 7:

Vazhdoni me njësinë mësimore ku do të flitet për rolin dhe rëndësinë e përdorimit të mjeteve apo veglave të ndryshme. Nisuni nga motoja se " veglat nuk janë lodra".



### Hapi 8:

Inkurajoni nxënësit që pas fazës së dizajnit të mundohen t'i bëjnë maketat e makinave të tyre. Pas grumbullimit të të gjitha punimeve dhe maketave bëni një ekspozitë në shkollë ku edhe do të përzgjedhen pesë punimet më të mira me të cilat shkolla do ta vazhdojë konkurrimin në nivele më të larta komunale ose nacionale.



### Diskutim me nxënësit

- *Pyetni nxënësit që të shpjegojnë se pse është me rëndësi që për lehtësimin e procesit të riciklimit të bëhet ndarja e mbeturinave dhe shtypja e kanaqeve dhe shisheve të plastikës*
- *Kërkoni nga nxënësit të shpjegojnë se pse së pari është me rëndësi të bëhet dizajni i një makine e pastaj të shkohet në fazën e modelimit dhe konstruktimit të produktit final.*
- *Kërkoni nga nxënësit të shpjegojnë se pse makinat së pari duhet të testohen.*
- *Kërkoni nga nxënësit të shpjegojnë se sa më e lehtë është që shtypja e kanaqeve të bëhet me anë të makinës se sa të bëhet me dorë.*



### Disa fakte për riciklimin



#### Riciklimi i letrës

- *Me riciklimin ose ripërdorimin e 1 ton letër ne do t'i ruajmë 17 drunj nga prerja dhe do të ruajmë aq energji sa është e nevojshme për ngrohjen e një banese mesatare për 6 muaj.*
- *Në vitin 2001 Amerikanët kanë ricikluar afërsisht 36.7 milion ton letër.*



### Riciklimi i plastikës

- *Me riciklimin e jo më pak se pesë shisheve plastike të ujit mund të prodhohet një xhaketë sportive. Përveç xhaketave sportive me riciklim të shisheve të plastikës prodhohen edhe veshje tjera.*
- *Amerikanët gjatë vitit 2008 kanë ricikluar 2.120 mijë ton plastikë.*

### Riciklimi i aluminit

- *Me riciklimin e aluminit kursehet 95% e energjisë së shpenzuar për t'u prodhuar alumin nga fillimi.*
- *Amerikanët fitojnë mesatarisht 1 bilion dollarë në vit nga procesi i riciklimit të aluminit.*
- *Nga alumini i ricikluar në vitin 2001 në SHBA ka qenë e mundur të ndërtohen 14 aeroplanë.*



### Riciklimi i qelqit

- *Shumica e gotave dhe e poçeve të qelqit prodhohen nga qelqi i ricikluar.*
- *Prodhimi i çdo toni të gotave të qelqit rezulton në ndotjen e ajrit, por me riciklimin e qelqit kjo ndotje zvogëlohet përafërsisht 30% .*
- *Në vitin 2008 në SHBA janë ricikluar afërsisht 2.81 milion ton të gotave të qelqit*

## 9.3 Klubet e Gjelbra



### Koncepti i krijimit të Klubeve të Gjelbra

Klubet e Gjelbra kanë për qëllim t'i pajisin nxënësit me njohuri, shkathtësi dhe të kuptuar përmes përvojave praktike në lidhje me mjedisin e tyre përreth, ndërveprimit me të dhe problemeve në të, si dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për vëzhgim, eksperimentim, hulumtim dhe regjistrim në mënyrë që të kenë arsyeshmëri për mbrojtje të mjedisit.

### Klubet e Gjelbra ofrojnë mundësi për:

- Të mësuar praktikisht dhe të bazuar në përvojë reale, të cilat mundësi do t'i fuqizojnë nxënësit që të promovojnë praktika të favorshme për mjedisin.
- Ndërtimin e partneritetit me komunitetet lokale për të zhvilluar dhe implementuar projekte dhe programe që do të rezultojnë në një mjedis më të shëndoshë dhe shkolla më të sigurta.
- T'u siguruar nxënësve mundësi të mësojnë për rrethin e tyre, dhe të përfshihen në projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me mjedisin.
- Ta ngritur vetëdijen e nxënësve mbi mjedisin dhe të zhvillojnë shkathtësi sociale dhe shkathtësi për jetë.

### Përfitimet nga prezenca e Klubeve të Gjelbra në shkollën tuaj:

- Mjedis të shëndoshë dhe të sigurt mësimi.
- Performancë të lartë të nxënësve.
- Lidhje të mira në mes të komunitetit dhe shkollës.
- Përgatitje të nxënësve për të kuptuar dhe vepruar në lidhje me sfidat momentale dhe të ardhshme të mjedisit.
- Forcon shkollat duke kursyer të holla përmes kursimit të energjisë dhe riciklimit të mbeturinave.

### Shembuj të aktiviteteve të Klubeve të Gjelbra

- Krijimi i një sistemi riciklimi në shkollë.
- Krijimi i lodrave për fëmijë nga materialet e riciklueshme.
- Mbjellja e një kopshti organik që do të ofronte perime të freskëta për shkollën.
- Organizimi i një dite 'Udhëtim në një të ardhme më të mirë'.
- Promovimi i sistemit të riciklimit me rastin e Ditës e Tokës.
- Nisma e një projekti 'kompoti i shkollës' duke përdorur ushqimet e mbetura.
- Organizimi i një ngjarjeje të veçantë si "Krijimi i Ditës kur u themi Jo Mbeturinave" apo "Dita e Tokës".
- Krijimi i posterave për t'i edukuar të tjerët mbi atë që mund të bëjnë për ta mbrojtur mjedisin.





## Modeli i Aktivitetit 1.

### Krijoni postera me veprime për mbrojtjen e mjedisit

Pasi që Klubet e Gjelbra do të shërbejnë si qendra për zhvillimin, nxitjen dhe shpërndarjen e mëtutjeshme të njohurive, vetëdijesimit dhe të kuptuarit për zhvillimin e mjedisit – sjelljes miqësore në mes të nxënësve, mësimeve dhe komunitetit të gjerë, një nga mënyrat për ta angazhuar tërë shkollën në veprim dhe për t'i vetëdijësuar se ka shumë mënyra për mbrojtjen e mjedisit me pak përpjekje, janë duke dizajnuar posterë me porosi të qarta dhe veprime në të.


### Udhëzimet për aktivitet

Aktiviteti mund të ndërlidhet me lëndët ekzistuese, si biologjia, arti, fizika, matematika, edukata qytetare, si aktivitet ndërlëndor, dhe u ndihmon nxënësve t'i zhvillojnë shkathtësitë relevante si kreativiteti, puna ekipore, hulumtimi, etj. Gjatë organizimit të aktivitetit në shkollën tuaj gjithnjë:

- Organizoni nxënësit të punojnë në grupe të përziera, dhe t'i shkëmbejnë idetë e veta.
- Shfrytëzoni imagjinatën dhe kreativitetin e nxënësve për dizajnimin e posterëve.
- Porosia e posterëve tuaj le të jetë e qartë.
- Posterit duhet të thotë shumë përmes imazheve dhe porosive përkrahëse
- Përfshini prindërit e nxënësve për t'i përkrahur nxënësit me burime, dhe për t'i ndihmuar ata gjatë vendosjes së tyre në shkollë.

### Deri në ç'masë po i arrini qëllimet tuaja?

Posterët mund të vendosen çdokund: në klasë, korridore, hyrje të shkollës, etj., ku mund të shihen nga të gjithë, dhe janë mjet i mirë për t'i vetëdijësuar dhe për t'i bërë më aktiv në nismën e ndryshimit të sjelljes së nxënësve në shkollë dhe shtëpitë e tyre. Nxënësit e kanë entuziazmin dhe vëmendjen për të mësuar diçka të re dhe për t'i përcjellur njohuritë te prindërit e tyre, si dhe për të inkorporuar ide të reja në rutinën e tyre të përditshme.



### Cili është hapi i ardhshëm i planit shkollor?

Planifikoni organizimin e një ekspozite dhe ftoni palët e ndryshme të interesit. Nxënësit mund t'i promovojnë nevojat e shkollës përmes posterëve për zëvendësimin e poçave në shkollë, nevojën për shporta për riciklim, përkrahjen për mbjelljen e drunjëve në oborrin e shkollës, etj. Me përpjekjet tuaja dhe përkrahje të vogël nga kompanitë tregoni përkrahje tuaj për planetin dhe ndihmoni në ndryshimin e qëndrimit duke i afishuar posterët:





## Model i Aktivitetit 2.

### Si ta krijojmë një Ditë të suksesshme të Aktivitetit mbi Mjedisin

Ky dokument i paraqet hapat që duhet ndërmarrë për ta organizuar një ditë të suksesshme me një aktiv të tërë për Ditën e Aktiviteteve të Mjedisit. Idealisht, kjo ditë do të duhej të jetë në pajtim me ditën ndërkombëtare, kombëtare apo rajonale të mjedisit, p.sh.: 22 prill, Dita e Tokës.

Qëllimi i këtij aktiviteti është të:

1. ***Ngritë vetëdijen rreth çështjeve të mjedisit***
2. ***U mundësojë nxënësve të marrin pjesë në përvoja të fuqishme dhe kuptimplota rreth temave të mjedisit***
3. ***Ofrojë mundësi që lëndët e ndryshme shkollore të punojnë së bashku mbi temat që kanë të bëjnë me mjedisin***
4. ***Sigurojë mundësi për nxënësit, shkollën dhe komunitetin të bashkëpunojnë mbi çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin***
5. ***Sigurojë mundësi që nxënësit ta udhëheqin të nxënit***
6. ***Ofrojë mundësi për t'u kënaqur duke mësuar***

Dita e merr formën e një vargu aktiviteteve të punëtorisë në të cilat do të marrin pjesë nxënësit. Punëtorja do të udhëhiqet nga një apo dy nxënës të cilët kanë qenë të përfshirë në planifikimin e ditës si dhe partnerët e komunitetit të përkrahur nga mësimdhënësi. Partneriteti është në qendër të kësaj ngjarjeje.

Fillimi i procesit duhet të përfshijë një mësimdhënësi udhëheqës i cili do të sigurojë që drejtori i shkollës dhe udhëheqësit e tjerë të rëndësishëm të shkollës pajtohen me qëllimin e ditës. Marrëveshja për këtë do të duhet të arrihet disa muaj para ditës së planifikuar. Së dyti, mësimdhënësi udhëheqës duhet ta organizojë një takim për ta mbledhur personelin e interesuar apo duke iu qasur personelit për të cilin mësimdhënësi udhëheqës beson se mund të jenë të përkushtuar ndaj principeve të ditës. Përkushtimi i personelit është thelbësor.

Mësimdhënësi udhëheqës më pas i rekruton nxënësit në *grupin punues* për të ndihmuar në planifikimin dhe organizimin e ditës. Në rastin më të mirë ata do të vinin nga Klubi i Gjellbër por si alternativë mësimdhënësi udhëheqës mund ta promovojë idenë e përfshirjes në udhëheqjen e një dite të tillë duke e informuar organin e nxënësve të shkollës përmes këshillit të shkollës apo një organi të ngjashëm. Çdo nxënës që rekrutohet duhet të jetë i vetëdijshëm se duhet të marrin përgjegjësi për të punuar me mësimdhënësi tjerë dhe partnerë të komunitetit gjatë organizimit të një pjese të ditës.

Organizoni një varg takimesh me personelin dhe nxënësit e interesuar. Shpjegoni se dita do të jetë për të gjithë nxënësit e një aktiviteti dhe se mësimdhënësit dhe nxënësit do të duhet të punojnë së bashku për ta planifikuar punëtorinë së bashku me një partner nga komuniteti. Filloni të mbledhni ide mbi llojin e punëtorive që do të mund të organizohen.

Në vijim janë disa ide:

1. **Planifikimi për ligje më të mira kombëtare mbi mjedisin**
2. **Promovimi i rëndësisë së riciklimit në mesin e të rinjve**
3. **Shfrytëzimi më i mirë i materialeve të përdorshme**
4. **Hartimi i planit të veprimit të komunitetit mbi mjedisin për komunitetin në të cilin gjendet shkolla**
5. **Përmirësimi i mjedisit shkollor**
6. **Ndërmarrja e veprimeve për ta zvogëluar sasinë e mbeturinave në shkollë**
7. **Krijimi i një plani tematik mbi NLM-në për shfrytëzim nga mësimdhënësit**
8. **Dizajnimi dhe mbajtja e një njësie mbi NLM-në për nxënësit e një shkolle tjetër apo klase më të ulët.**

Në secilin rast, nxënësit vullnetarë dhe çdo mësimdhënës i rekrutuar duhet ta identifikojë një agjenci apo partner të jashtëm nga komuniteti i cili ka ekspertizë relevante për punën që do të bëhet. Më pas ata duhet të caktojnë takim me partnerin e tyre dhe të fillojnë të mbledhin ide dhe ta planifikojnë punëtorinë. Secila punëtori duhet të zgjasë 90 minuta, të jetë aktive dhe me pjesëmarrje, të përfshijë mësim aktiv dhe të prodhojë një *produkt* për ekspozim apo përdorim në *Ngjarjen Trego dhe Prezanto* në fund të ditës. Produkti mund të jetë i bazuar në poster, film, objekt aktual, këngë, seri të fotografive, dokument të politikave, një njësi apo planifikim tematik, etj. Ndoshta do të duhet të organizohen disa takime me partnerë për t'u pajtuar mbi planin e punëtorisë. Grupi planifikues për secilën punëtori duhet të ketë partnerë të barabartë për t'u siguruar se ekipi punon mirë së bashku. Pasi të planifikohet punëtorja, duhet të arrihet pajtim mbi orarin e ditës. Duhet të ketë kohë për:

1. Mirëseardhjen e përgjithshme dhe hyrjen për ditën me të gjithë nxënësit e një niveli së bashku për rreth 15 minuta
2. Punëtoritë, secila nga 120 minuta. Nxënësit pjesëmarrës do të marrin pjesë vetëm në një punëtori gjatë ditës
3. Në *Ngjarje Trego dhe Prezanto* në fund të ditës ku ekspozohen të gjitha produktet dhe nxënësit pjesëmarrës mund të shohin çka ka prodhuar secila punëtori. Secila punëtori do ta ketë një ekip të vogël për ta promovuar produktin e vet. Anëtarët e komunitetit, gazetarët dhe mediat, anëtarët e qeverisë dhe komunës si dhe miqtë kryesorë të shkollës duhet të ftohen në këtë pjesë të ditës.
4. Një aktivitet plenar për të gjithë ku shpërndahen fletët e vlerësimit dhe plotësohen nga të gjithë nxënësit, dhe falënderohen partnerët nga komuniteti.
5. Anëtarët e punëtorisë e pastrojnë tavolinën e vet para largimit
6. Ekipi i cili e ka planifikuar ditën duhet të takohet për ta rishikuar ditën, për t'i shikuar fletët e vlerësimit, shkruar letra falënderimi për partnerët e komunitetit dhe për të menduar për punë të përbashkët në të ardhmen.
7. Kur është e mundshme, duhet të shkruhet një raport për ueb faqen e shkollës apo komunitetit
8. Është e rëndësishme të ketë publicitet të mirë për progresin me planifikimin e ditës, cilat janë marrëveshjet që dita të ketë sukses, të mendohet se si do të përfshihen mësimdhënësit që nuk janë të përfshirë në punëtori por japin mësim në nivelin i cili do të jetë në punëtori. Secila punëtori duhet të ketë më së shumti 25 nxënës dhe të ketë gjithnjë një mësimdhënës prezent i cili do të jetë përgjegjës për disiplinë; udhëheqësit e punëtorisë do t'i zbatojnë detyrat e tyre.

## 10. Mënyra të reja për vlerësim: VPN



Tradicionalisht vlerësimi ka shërbyer për qëllime raportimi dhe ka ndodhur pasi që ka ndodhur nxënia. Për shembull nxënësve u jepen nota në fund të vitit ose hynë në test për të vlerësuar se çka kanë mësuar. Ky lloj i vlerësimit, i cili i përmbledhë të arriturat e nxënësit për një kohë të caktuar quhet Vlerësim Sumativ apo Vlerësim i të Nxënësit (ViN).

Megjithatë, nëse informatat për të nxënësit e nxënësve përdoren si informata kthyesë në mënyrë që nxënësit dhe mësuesit ta përmirësojnë mësimdhënien dhe të nxënësit në të ardhmen, atëherë vlerësimi i tillë bëhet Vlerësim Formativ apo Vlerësim për Nxënës (VpN).

### Vlerësimi mund ta përmirësojë të nxënësit nëse:

- Ofron informata efektive për nxënësit
- Çon drejt ndryshimeve në mësimdhënie për ta bërë atë më efektive
- Ngrit motivimin dhe vetë-respektin e nxënësve, e që janë thelbësore për të nxënësit
- I përfshin nxënësit në mënyrë aktive që ta kuptojnë se si mund të përmirësohen.

Vlerësimi efektiv mund të ofrojë të kuptuar më të thellë në lidhje me progresin e nxënësve për:

- Marrjen e njohurive të reja
- Zhvillimin e shkathtësive, mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve
- Zhvillimin e shkathtësive të reja të komunikimit të shkruar dhe verbal
- Zhvillimin e shkathtësive për punë në grupe

Në rastin kur kemi vlerësim të cilësisë së lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet t'i jenë përgjegjës pyetjeve në vijim:

- Cilat synime të të nxënësit duhet t'i arrijë nxënësi?
- Si po përparon ai/ajo për arritjen e këtyre synimeve?
- Cilët do të jenë hapat e ardhshëm në mësimdhënie dhe nxënie?
- Cilat janë dëshmitë që tregojnë se synimet e të nxënësit janë arritur?

## 10.1 Mënyrat e vetëvlerësimit në shkolla

Mënyrat e Vetëvlerësimit NLM u mundësojnë drejtorëve të shkollave dhe mësuesve udhëheqës të NLM-së ta përcjellin progresin në mënyrë sistematike për zhvillimin e edukimit mbi mjedisin në shkollën e tyre. Këto mënyra u ndihmojnë drejtorëve të shkollave të ndërmarrin një qasje më gjithëpërfshirëse dhe më të integruar në lidhje me NLM-në gjë që i ndërlidhë komponentet e mjedisit në kurrikulë, mjedisin në komunitetin e shkollës dhe mjedisin në komunitetin e gjerë jashtë shkollës.

## 10.2 Arsyetimi dhe Modelet e Mënyrave të Vetëvlerësimit

Drejtorët e shkollave dhe mësuesit udhëheqës të NLM-së identifikojnë nivelin në të cilin mendojnë se gjendet shkolla e tyre sa i përket praktikës në lidhje me dëshmitë e siguruar për secilën nga gjashtë fushat e zhvillimit: Udhëheqja, Burimet dhe Menaxhimi i tyre, Mësimdhënia dhe të Nxënit, Zhvillimi i Personelit, Monitorimi dhe Vlerësimi dhe Përfshirja e Prindërve dhe Komunitetit. Progresi i shkollës i shprehur në katër faza të paraqitura në arsyetim: Fare i Paktë, në Zhvillim, Praktikë e Suksesshme dhe Praktikë e Dëshirueshme, mund të rishikohet në mënyrë sistematike. Tabelat në këtë pjesë ofrojnë hapësirë për t'i planifikuar dhe monitoruar veprimet tuaja.

>> **Instrumentin shkollor të vetëvlerësimit për mësimin e NLM-së, e gjeni të bashkangjitur në fund të doracakut.**

## 10.3 Veprimi, Planifikimi dhe Monitorimi i Mënyrave për Vetëvlerësim

Veprimet shënohen për secilën nga gjashtë fushat dhe katër fazat e zhvillimit për t'u ndihmuar drejtorëve të shkollave dhe mësuesve udhëheqës të lëndës t'i ndërmarrin hapat e ardhshëm në caktimin e prioriteteve dhe ngritjen e NLM-së në shkollat e tyre. Për shembull, një shkollë mund të dëshirojë ta bëjë mësimdhënien dhe të nxënit prioritet, dhe natyrisht, secila shkollë që është në nivelin fare i paktë do të ketë nevojë që patjetër ta bëjë udhëheqjen prioritet.

### Pse të përdoren mënyrat e tilla?

Drejtorët e shkollave mund t'i përdorin këto mënyra për ta vlerësuar zbatimin dhe progresin përmes plotësimit të tabelës në mënyrë individuale dhe pastaj ta krahasojnë si grup në mënyrë që të pajtohen se në cilën fazë të zhvillimit është shkolla dhe të pajtohen për hapat e ardhshëm. Ato mund të përdoren nga mësuesit e lëndëve apo nga i tërë personeli, dhe atë jo vetëm për ta ngritur vetëdijen, por edhe për të arritur marrëveshje mbi atë që ka nevojë të bëhet dhe për identifikimin e personave që do ta kryejnë atë detyrë.

Në cilëndo mënyrë që përdoren, ato duhet të rishikohen kohë pas kohe që të mundësojnë monitorimin e progresit dhe identifikimin e veprimeve të ardhshme. Ato mund të përdoren edhe për t'i identifikuar fushat në të cilat mësuesit udhëheqës të mjedisit, mësuesit tjerë të lëndëve të NLM-së, personeli me përvojë dhe prindërit kanë nevojë për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

## 11. Pse të zbatohet NLM-ja në nivel të shkollës?

### Edukimi mbi mjedisin e ngrit angazhimin e nxënësve në të nxënit.

Disa analiza kanë dëshmuar përfitime jashtëzakonisht të mëdha nga edukimi mbi mjedisin në shkollat tona. Kur edukimi mbi mjedisin integrohet në kurrikulën e shkencës, ai ngrit të arriturat e nxënësve në shkencë e edhe në lëndët tjera në mënyrë të dukshme. Ngritja e tillë ndodhë për shkak se edukimi mbi mjedisin e ndërlidhë mësimin në klasë me botën reale. Nxënësve, kur u mundësohet të bëjnë zgjedhje vet, atëherë ata do t'i qasen shkencave mjedisore.

### Edukimi mbi mjedisin ngrit të arriturat e nxënësve në fushat ndër-disiplinare.

Kur edukimi mbi mjedisin integrohet në kurrikulën themelore apo përdoret si temë e integruar në kurrikulë, ai ka një ndikim pozitiv për të arriturat e nxënësve në shkenca, në lexim (ndonjëherë me sukses të theksuar), matematikë dhe në shkenca shoqërore. Studime të ndryshme kanë dëshmuar se shkollat të cilat i mësonin lëndët themelore duke e përdorur mjedisin si kontekst integruar, demonstironin edhe:

- *Zvogëlim të problemeve në disiplinë dhe menaxhim të klasës*
- *Ngritje në angazhim dhe entuziazëm për mësim dhe*
- *Krenari më të madhe dhe pronësi në të arriturat nga nxënësit.*

### Si të zbatohet NLM-ja në nivel të shkollës?

NLM-ja mund të organizohet në nivel të shkollës nëpërmjet të: kurseve të ngritjes profesionale pa shkëputje nga puna, aktiviteteve të klubeve të gjelbra, lëndëve zgjedhore, aktiviteteve jashtë klasës, bashkëpunimit me komunitetin e të tjera. Një shembull konkret është punëtorja tre ditore e Basic Education Program, e akredituar nga MASHT, e cila përqendrohet në: implementimin e kurrikulës së Kosovës, strategji të reja të mësimdhënies e të të nxënit, dhe në Partneritetin Shkollë-Komunitet.

- a) Qëllimi i implementimit të kurrikulës së Kosovës është të prezantohen principet e NPM-së dhe të hulumtohet koherenca me kurrikulën në NLM dhe kushteve për implementim të aktiviteteve.
- b) Qëllimi i strategjive të reja të mësimdhënies e të të nxënit është t'ua prezantojë pjesëmarrësve qasjet e reja të aktiviteteve të mësimdhënies dhe të nxënit në nivel të shkollës me theks në NLM. Gjithashtu, me që çështjet e mjedisit janë të ndërlidhura me natyrën rreth shkollës, mësimi jashtë klasës është pjesë e këtyre aktiviteteve.
- c) Partneriteti Shkollë-Komunitet synon:
  - *Ta kuptojnë rëndësinë e krijimit të NLM-së aktive e të qëndrueshme që është e ndërlidhur me qëllimet edukative dhe të shoqërisë civile.*
  - *Ta shohin se si NLM është një agjendë edukativo-arsimore që kërkon novacion brenda shkollave tona;*
  - *Të kuptojnë se si Klubet e Gjelbra dhe aktivitetet begatuese mund të zhvillohen në shkolla dhe të kenë ndikim tek komuniteti në të cilin ndodhet shkolla;*
  - *Ta lidhin veprimin e nxënësve dhe komunitetin e qëndrueshëm edhe një herë me bërthamën e mësimdhënies dhe nxënies në kurrikulën e shkollës.*



## 12. Faqet tuaja personale

### 12.1 Portfolio e Mësimdhënësit (Dosja)



Portfolio është pjesë thelbësore e zhvillimit profesional të mësimdhënësit. Ajo është një dokument që i regjistron të arriturat e mësimdhënësit, u lejon atyre të reflektojnë mbi mësimdhënien e tyre dhe e përkrah zbatimin për ngritje dhe promovim. Portfolio e mësimdhënësit është dokument i gjallë; ai ndryshon me kohë përderisa mësimdhënësit e vlerësojnë mësimdhënien e tyre, reflektojnë dhe veprojnë në bazë të rezultateve, si dhe zhvillojnë qasje të ndryshme për mësimdhënie.

Portfolio është zakonisht e shkruar si reflektim i mësimdhënësit ndaj mësimdhënies dhe principeve të cilat i kanë përdorur mësimdhënësit për të informuar për qasjen e tyre ndaj punës akademike. Dokumenti do të theksojë ndryshimet të cilat i ka bërë mësimdhënësi ndaj mësimdhënies së vet në bazë të konsultimit të literaturës edukative, vlerësimeve të nxënësve dhe kolegëve, hulumtimeve që i ka bërë mësimdhënësi mbi të nxënit dhe mësimdhënien dhe pjesëmarrjen në programe të ngritjes profesionale.

Nuk ekziston një mënyrë e caktuar se si duhet të shkruhet një portfolio e mësimdhënësit; ai është dokument origjinal i mësimdhënësit. Nga mësimdhënësit nuk pritet ta arrijnë ndonjë standard hipotetik; dokumenti është i përbërë nga komente mbi reflektimet dhe zhvillimet. Është plotësisht e pranueshme të reflektohet mbi aktivitetet e mësimdhënies të cilat nuk kanë pasur efektin e dëshirueshëm për ngritjen e të nxënit të nxënësve, si edhe mbi aktivitetet që kanë qenë të suksesshme. Portfoliot zhvillohen kryesisht në faza, nga mbledhja e informatave e deri te hulumtimi i metodave të reja të mësimdhënies përmes reflektimeve dhe veprimeve të informuara.

Ata që i lexojnë portfoliot e mësimdhënësve për ngritje apo zhvillim do të kërkojnë dëshmi të cilat mësimdhënësi i ka për:

- **Qasjen ndaj mësimdhënies**
- **Informatën nga nxënësit dhe kolegët mbi mësimdhënien dhe veprimin e mësimdhënësit në bazë të rezultateve**
- **Reflektimin mbi atë se si ka ndikuar mësimdhënien në të nxënit e nxënësve**
- **Ndikimin në të nxënit e nxënësve**

## Komponentet për portfolion tuaj

Nuk ekziston ndonjë formë e caktuar për portfolion e mësimit. Secila portfolio është e veçantë por përmban kryesisht shumicën e informatave në vijim:

- Informata personale, duke përfshirë emrin, departamentin, informata për kontakt
- Një listë të përmbajtjes, që të jetë më e lehtë për lexuesin të kërkojë
- Një hyrje që përmban detyrat tuaja administrative dhe të mësimit
- Një përmbledhje të filozofisë tuaj të mësimit, duke përfshirë referenca për planet e shkollës për të nxënësit dhe mësuesin
- Reflektim kritik mbi aktivitetet tuaja të mësimit dhe ndikimin e tyre mbi nxënësit dhe shkollën tuaj. Kjo përfshin përshkrimin e qasjes që e keni përdorur për një aktivitet të caktuar, duke përfshirë kontekstin dhe arsyen për atë qasje. Mund të komentoni mbi vështirësitë apo rezultatet e papritura nga aktiviteti, të diskutoni ndonjë vlerësim të nxënësve apo kolegëve, dhe të shtoni një përmbledhje reflektive të aspekteve pozitive që kanë qenë rezultat i aktivitetit si dhe ndryshimet që do t'i bënit në rast të përsëritjes së aktivitetit.
- Një përmbledhje të aktivitetit për zhvillim profesional.
- Një përmbledhje të zhvillimeve të ardhshme që do të kishit dëshirë t'i ndërmerrnit dhe një afat kohor për zbatimin e tyre
- Një plan të veprimit për ngritje në mësuesin tuaj
- Prezantime në konferenca, publikime, shpërblime dhe grante që kanë të bëjnë me mësuesin dhe të nxënësit
- Shtojca me dëshmi të dokumentuara që i përkrahin detajet e listuara më lart.

Portfolio juaj duhet të jetë e qartë dhe specifike me faqe të përshtatshme përmbajtësore. Do të ishte përparësi nëse i listoni referencat relevante nga literatura e cila është përdorur për të informuar mbi qasjen tuaj ndaj mësimit apo veprimeve që i keni ndërmarrë si rezultat i vlerësimeve dhe reflektimeve. Është e përshtatshme po ta mbështetni ndonjë deklaratë që e bëni me dëshmi të dokumentuara dhe citime nga literatura.

---

## 13. Referencat

---

1. Qendra për mësimdhënie dhe ngritje profesionale; Zhvillimi i Dosjes tuaj Mësimdhënëse; Universiteti i Adelaide-s, Australi (2005)
2. Doracak për Klasat e Shekullit 21, / autorë Keith Prenton, Snezana Jankulovska, Shkup 2009, USAID-Projekti për Arsimin Fillor
3. Dokument Referencë për Metodologjinë e të Nxënit, Përgatitur për Zyrën e Programeve NAVSEA për Monitorimin e Performancës, Trajnim dhe Vlerësim (PMS 430)
4. Praktikat e Përmbushura të Edukatorëve; Kompetencat për Mësimdhënësit e Shekullit Njëzet e Një; Departamenti i Edukimit të Floridës, Tallahassee, Floridë
5. Autoriteti i Kualifikimit dhe Kurrikulumit; Zhvillimi i Qëndrueshëm në Veprim; Strategji të Qëndrueshme të shkollës të DCSF, Britani e Madhe, 2009
6. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, Doracaku për Trajnimin e Trajnerëve, Jeto & Mëso Edukimi mbi Mjedisin 2009.
7. UNESCO-UNEP Programi Ndërkombëtar për Edukimin mbi Mjedisin; Aktivitete të Edukimit mbi Mjedisin për Shkolla Fillore
8. Udhëzuesi i mësimdhënësit për zvogëlimin e mbeturinave dhe ruajtjen e burimeve, EPA qershor 2005





***DORACAKU  
I FUSHATËS  
për Klubet e Gjelbra***

**Instrumentari i Mësimdhënësit  
(dhe nxënësit!)**

Nga Chris Waller

## Shënime për mësimdhënësit

**Demokracitë efikase kanë nevojë për qytetarë efektivë, qytetarët efektivë janë fushatë-bërës të efektshëm, dhe fushatë-bërësit e efektshëm dinë si t'i përdorin mediat dixhitale.**

Këto aktivitete i pajisin mësimdhënësit me ide dhe mjete për t'u mundësuar të rinjve që të bëhen fushatë-bërës efikasë. Ato janë domethënëse (për të rinjtë) dhe të menaxhueshme (për mësimdhënësit). Çka është më e rëndësishme, këto janë mjete të cilat mund të përdoren me grupe nxënësish gjatë gjithë vitit të punës dhe jo vetëm me pak nxënës të zgjedhur në klubet jashtëshkollore.

Nuk është e thënë që t'i merrni të gjitha aktivitetet – zgjidhni disa që u përshtaten nevojave tuaja, shkathtësive të nxënësve, çështjeve që zgjedhin ata dhe kohës që keni në dispozicion.

### **Të kuptuarit e punës në themel:**

Në mënyrë që bërja e fushatës të jetë efektive ne duhet t'u japim nxënësve mundësinë për të bërë dy gjëra... dy gjëra që nuk ndodhin shpesh në shkolla. Ne duhet t'ua japim atyre ZGJEDHJEN, t'ua mundësojmë sjelljen e NDRYSHIMIT.

- **Zgjedhje** – nxënësit duhet të arrijnë t'i zgjedhin çështjet (kauzat) për të cilat do të bëjnë fushatë, dhe mënyrën se si do ta jetësojnë atë. Nëse bëhet fjalë për vlerën e demokracisë, atëherë këtë porosi (mesazh) tonën duhet ta pasqyrojmë në qasjen ndaj mësimdhënies. Gandi e kishte kuptuar këtë kur ka thënë "Ne mund t'u mësojmë të tjerëve për drejtësinë dhe demokracinë vetëm përmes mënyrave të drejta dhe demokratike".
- **Ndryshimi** – nëse duam që të rinjtë të ndihen politikisht të fuqishëm, ata duhet të kenë pushtet, tërësinë e përvojës së të vepruarit politikisht. Me fjalë të tjera, duhet që ata vetë të ndërmarrin veprime të cilat kanë potencial për të ndryshuar botën rreth tyre.

Ky instrumentar ju jep aktivitetet dhe strukturën për t'u mundësuar nxënësve që të bëjnë pikërisht këtë. Ata duhet të ndjekin këto hapa:

**Hapi 1:**

CILA është kauza për të cilën doni të bëni fushatë?

**Hapi 2:**

KUSH e ka pushtetin për ta zgjidhur këtë çështje?

**Hapi 3:**

Si mund t'i bindni njerëzit e pushtetshëm për të dhënë përgjigje?

**Hapi 4:**

KU është plani i fushatës suaj?

**Hapi 5:**

ÇFARË keni mësuar nga fushata?

**Mendime për fund:**

Kur nxënësit fillojnë fushatën, shpesh u duket se nuk kanë aq pushtet apo ndikim sa duhet për të ndryshuar ndonjë gjë. Një nga rolet tona si mësues të Mjedisit është të sigurohemi që po i orientojmë nxënësit drejt aspekteve të fushatës ku ka të paktën gjasa logjike të një rezultati pozitiv. Kjo mund të ketë më shumë gjasë (megjithëse jo domosdoshmërisht) nëse fushata ka të bëjë me çështje shkolle (pra ndryshe do të ishte sikur të kishte të bënte me çështje kombëtare apo globale).

Organizimi i kohës në fushatë është shumë i rëndësishëm. Disa çështje ka më shumë gjasë të ndryshojnë në momente të caktuara. Për shembull, autoritetet komunale zakonisht kanë tendencë t'i rregullojnë rrugët kur afrohet fundi i vitit financiar, kur e dinë që duhet ta shpenzojnë buxhetin e tyre – pra, nëse rrugët afër shkollës suaj kanë nevojë për riparim, përpiquni që ta organizoni këtë fushatë rreth asaj periudhe kohore.

Dhe, në fund, ndryshimet politike marrin shumë kohë, kështu që duhet t'ua bëni të qartë nxënësve lidhjen mes fushatës së tyre dhe rezultatit pozitiv të saj, posaçërisht në rast se rezultati vjen shumë muaj pas fillimit të fushatës së tyre.

## Hapi 1: Cila është kauza për të cilën do të bëni fushatë?

**Shumë të rinj (dhe të rritur!) nuk besojnë se mund të sjellin ndryshim në botën rreth tyre. Shkurtimisht shpjegoni sfidën apo detyrën e fushatës që do t'ua caktoni.**

Nuk mund të bëni fushatë pa pasur një kauzë tuajën! Pra, hapi i parë është që nxënësit të zgjedhin një të tillë! Ka shumë rëndësi që të jenë nxënësit ata që bëjnë zgjedhjen – pikërisht nga kjo mund të varet interesimi i tyre dhe mirëqenia juaj mendore! Sidoqoftë, edhe zgjedhjet pa fund mund të shkaktojnë probleme – për ju dhe për ata. Mbase është më mirë që ju t'u ofroni një 'zgjedhje të strukturuar', pra një zgjedhje brenda disa kufijve të caktuar. Në Aktivitetin 1.1, struktura është e tillë që fushata ka të bëjë me zgjidhjen e problemeve më të zakonshme me të cilat përballen nxënësit në shkollë.

Aspekti i dytë i zgjedhjes ka lidhje me mënyrën e punës, pra nëse gjithë klasa do të punojë bashkë apo nëse nxënësit do të punojnë në grupe më të vogla dhe do të punojnë mbi disa çështje. Zakonisht kjo qasje krijon motivacion tek nxënësit sepse u jep mundësinë që ata të bëjnë fushatë për diçka që e kanë shumë për zemër.

Vetëm bëni kujdes për tri gjëra:

- 1) Jini shumë i qartë me nxënësit në lidhje me qasjen tuaj para fillimit të punës mbi projektin;
- 2) Nëse i lejon nxënësit të punojnë në grupe më të vogla, kini parasysh që këto grupe funksionojnë më mirë kur kanë jo më shumë se katër anëtarë;
- 3) Kjo qasje nënkupton më shumë punë përgatitore për ju, sepse mund t'ju duhet të përgatisni materiale mbështetëse për një gamë të gjerë të çështjeve.

### Aktiviteti 1.1

Një mënyrë ndëraktive për t'i ndihmuar nxënësit që të zgjedhin kauzën (apo çështjen) për fushatën e tyre është të shkruani disa opsione të ndryshme mbi një fletë të formatit A3 të cilën e shtroni në tokë. Mund të lini edhe disa opsione të zbrazëta. Organizojeni grupin në mënyrë të atillë që të ulen në formë rrethi, rrotull opsioneve, dhe pastaj:

- Kërkoni prej tyre të diskutojnë mbi opsionet e tyre të preferuara me një shok/shoqe për një minutë;
- Jepuni shansin për t'i bindur të tjerët në grup që opsioni 'i tyre' është zgjedhja më e mirë;
- U kërkoni që ta shkruajnë zgjedhjen e tyre në një fletushkë të verdhë ngjitesë dhe pastaj i ngjisni ato mbi fletën e duhur të formatit A3;
- Shtoni edhe fletushkat e tjera ngjitesë dhe do të keni:

### Varianti 1.2: Çfarë Ju Shqetëson?

Nëse kjo mënyrë e punës (fleta e shtruar në dysheme) është më ndëraktive sesa duhet, atëherë thjesht mund t'i jepni secilit nxënës nga një kopje të fletës 'Çfarë Ju Shqetëson?' dhe u thoni që të diskutojnë me një shok/shoqe e më pas të plotësojnë opsionin e vet.



**Varianti 1.3: Renditja**

Ose printoni opsionet në letra të prera (karta) dhe u kërkoni nxënësve që t'i rendisin sipas interesimit që ngjallin tek ata

Gjendja e banjove  
të shkollës

Terrenet e shkollës janë plot  
me mbeturina

Ka shumë ushqim në shkollë  
që shkon dëm

Rruga jonë për në shkollë  
nuk është e sigurt

Këshilli i shkollës sonë nuk  
punon shumë mirë

Të gjitha shishet plastike në  
shkollë hudhen në pleh

***Çfarë ju shqetëson?***

***Rendisni zgjedhjet nga shembujt e dhënë, ose jepni idetë tuaja.***

## Hapi 2: KUSH e ka pushtetin për ta zgjidhur kauzën e fushatës suaj?

Para se nxënësit të mund ta planifikojnë fushatën, ata duhet të mendojnë në lidhje me 'lojtarët e pushtetshëm' – njerëzit të cilët mund ta ndihmojnë ose mund ta dëmtojnë fushatën e tyre. Shumë lehtë mund të presupozohet se nxënësit i kanë këto informata, por shpeshherë nuk i kanë, dhe për këtë arsye është e rëndësishme të ndërmerret ky hap i fushatës paraprakisht.

Shpesh njerëzit përpiqen t'u mësojnë të tjerëve mbi lojtarët kyç të pushtetit (p.sh. roli i qeverisë, puna e deputetëve, si funksionon policia, me çfarë merren organizatat bamirëse) në mënyrë të izoluar nga çështjet që vërtet u interesojnë nxënësve. Është shumë më mirë nëse fillimisht identifikoni çështjen kryesore e më pas u mësoni atyre për lojtarët kryesorë. Në këtë mënyrë nxënësit mund të jenë vërtetë të interesuar sepse e kuptojnë që kanë nevojë të dinë më shumë për këto çështje në mënyrë që t'i arrijnë qëllimet e fushatës së tyre.

### Aktiviteti 2.1: Lojtarët e Pushtetshëm!

Printoni kartat e 'Lojtarëve të Pushtetshëm' dhe përshkrimet që u përshtaten. Përdorni vetëm ato që janë relevante për fushën tuaj dhe çështjet e interesit tuaj.

Jepini secilit grup të nxënësve një fletore të madhe (flip chart) mbi të cilën ndodhet grafiku (grid) i Lojtarëve të Pushtetshëm (Përkrahës, Kundërshtarë, Vendimmarrës, Ekspertë), u kërkonti t'i shohin kartat e Lojtarëve të Pushtetshëm një nga një dhe t'i përputhin me grafikun (grid) e Lojtarëve të Pushtetshëm. Nuk është e thënë që t'i përdorin të gjitha kartat; bile në fakt do të duhej që ata vetë t'i dallonin kartat të cilat duhet të vendosen në grafik (grid).

### Aktiviteti 2.2: Pozicionimi i Lojtarëve të Pushtetshëm

Tani nxënësit duhet të mendojnë me kujdes se cilët Lojtarë të Pushtetshëm mund të luajnë rol realisht në fushatën e tyre. Të gjithë do të donin që fushatën e tyre ta mbështeste Kryeministri, dhe ai vërtet që është mjaft i pushtetshëm, por nuk ka fort gjasë që ai të gjejë kohën për t'u përfshirë. Kështu që nxënësit duhet ta krahasojnë masën e pushtetit që ka Lojtari i Pushtetshëm me masën e vëmendjes që do të mund t'ua kushtonte ai atyre.

Kryeministri	Shefi i Kabinetit
Deputeti	Kryetari i Komunës
Kryetari i Kuvendit Komunal	Këshilltari Lokal
OJQ	Zyrtar i Këshillit
Shtypi Vendor	Shtypi Kombëtar
Policia	Bizneset Globale

Bizneset Vendore	Organizatat që Bëjnë Fushata
Bloggers	Drejtori i Shkollës
Të Famshëm	Mësimdhënës
Prindër	Anëtarë të Publikut
	JU!


<u>PËRKRAHËS</u>	<u>KUNDËRSHTARË</u>
<u>VENDIMMARRËS</u>	<u>EKSPERTË</u>

## Pozicionimi i Lojtarëve të Pushtetshëm

Zgjidhni Lojtarët e Pushtetshëm që mendoni se mund të spikasin në fushatën tuaj, dhe pastaj vendosini ata mbi këtë grafik (grid) sipas masës së PUSHTETIT që kanë dhe GADISHMËRISË që mendoni se mund të tregojnë. Kjo do t'ju ndihmojë të vendosni se cilët njerëz apo organizata janë më të rëndësishme për fushatën tuaj.

TË PUSHTETSHËM = këta njerëz mund të bëjnë dallim shumë të madh në fushatën tuaj

GADISHMËRIA = këta njerëz ka gjasë t'ju dëgjojnë dhe t'ju ndihmojnë.



## Hapi 3: Si mund t'i bindni ata që ta zgjidhin çështjen?

Inkurajimi i nxënësve që 'të ndërmarrin veprime' është krejt në rregull, por ata mund të mos e kenë idenë se çfarë nënkupton kjo apo se çfarë mund të jetë veprimi i duhur apo realist. Ky aktivitet mund t'i ndihmojë ata.

### Aktiviteti 3.1

Printoni Kartat e Veprimit në letër, fotokopjoni ato në karta dhe pritini një nga një. Kërkoni prej secilit grup të nxënësve që t'i shqyrtojnë të gjitha kartat dhe të vendosin se cilat veprime janë më të përshtatshme për fushatën e tyre. Ata mund t'i shkruajnë veprimet e tyre shpesh mbi kartat e zbrazëta.

### Aktiviteti 3.2

Pasi t'i kenë seleksionuar veprimet e tyre, vendosini ato mbi grafikun e 'Ndikimi-Vështirësia' të renditura sipas nivelit të vështirësisë që ata mendojnë se do të paraqitet gjatë zhvillimit të atij veprimi, dhe sipas masës së ndikimit që ata mendojnë se do të ketë.

Kjo do t'i ndihmojë kur të vijë faza e planifikimit të fushatës.

Shkruani një kumtesë për shtyp dhe dërgojani gazetave lokale për të tërhequr vëmendjen drejt kauzës së fushatës suaj. Ose, si ju duket organizimi i një ngjarjeje për mediat e cila tërheq mjaft vëmendje?

Organizoni një takim apo debat për të diskutuar rreth kauzës së fushatës suaj.

Krijoni një faqe interneti të fushatës me qëllim të ndërgjegjësimit dhe shtimit të radhëve tuaja (ndjekësve).

Bëni një video, galeri fotografish.

Ftoni njerëz të pushtetshëm në shkollën tuaj (si p.sh. një deputet të zonës apo përfaqësues të policisë) dhe bëni një prezantim para tyre.

Bëni një peticion në shkollë.

**Çfarë idesh të tjera keni? Shkruajini këtu.**

<p>Shkruani një email ose letër drejtuar personit që është përgjegjës për kauzën tuaj duke i kërkuar që të veprojë në këtë drejtim. U thoni edhe miqve tuaj që të dërgojnë emaila.</p>		
--	--	--

**Grafiku Ndikim - Vështirësi**

NDIKIMI			
	I Lartë	Mesatar	I Ulët
I Lartë			
Mesatar			
I Ulët			



## Hapi 4: Ku është plani i fushatës suaj?

Tani që nxënësit e kanë menduar procesin e fushatës, është koha e organizimit të ideve dhe shndërrimit të tyre në plan.

### Aktiviteti 4.1 Rrënjë & Fryte:

Ky aktivitet i ndihmon të rinjtë të përcaktojnë hollësitë e planit të fushatës së tyre. Kjo nuk është mënyrë apo mjet planifikues gjithëpërfshirës, por në shumë fushata të tjera do të përshtatet me shkathtësitë dhe përvojën e nxënësve. Vizatoni një skicë të përgjithshme të një peme mbi një fletë të madhe (flip chart). Më pas u kërkoni nxënësve t'u përgjigjen 4 pyetjeve rreth pemës.

### Aktiviteti 4.2 Shtegu i Fushatës:

Ky është një mjet planifikimi më i hollësishëm, dhe lidhet me të gjitha aktivitetet nga hapat e mëhershëm. Nxënësit nuk janë të detyruar t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve në 'shteg' – disa mund të mos jenë relevante – por do t'i ndihmojnë ata që të mendojnë për të gjitha gjërat që duhet t'i kenë gati para se të fillojë fushata.

### Aktiviteti 4.3 Probleme dhe Zgjidhje

Një variant i aktiviteteve të lartcekura, ose ato që u shtohen, mund të jetë edhe t'u kërkoni nxënësve që të mendojnë lidhur me pengesat apo kundërshtarët e ndryshëm që mund të hasin gjatë fushatës së tyre, dhe lidhur me zgjidhjet apo përkrahësit që mund t'i ndihmojnë për t'i tejkaluar ato.


## Rrënjë & Fryte

4. Çfarë veprimi KONKRET mund të ndërmerrni për ta ndryshuar këtë?

3. Kush është përgjegjës apo kush e ka fuqinë që ta zgjidhë këtë problem?


1. Cili është problemi që keni zgjedhur?

2. Cilat janë 'rrënjët' e këtij problemi?



## *Cilat janë rreziqet e mundshme të fushatës sonë?*


Në çdo fushatë duhet të merrni parasysh rrezikun e mundshëm të ndonjë veprimi apo vendimi. Përdorni diagramin e mëposhtëm për të matur rreziqet duke i ndarë në Fitime dhe Humbje. Përpiquni t'i vendosni ato në dy anët e kundërta të kolovajzës. Natyrisht që mes tyre mund të mos ketë ekuilibër; dhe në këtë rast duhet të vendosni se si t'ia bëni. Mos harroni, jo çdo vendim është pa rrezik. Gjithmonë përpiquni të merrni vendime mbi baza të mençura dhe të menduara mirë, e jo mbi bazën e instinktit të momentit!



**FITIMET**

**HUMBJET**

## Shtegu i Fushatës



## Pengesa & Zgjidhje, Gjarpërinj & Shkallë!

Shkruani ndonjë pengesë apo kundërshtarë me të cilët mund të përballeni gjatë kohës që përpiqeni t'i arrini qëllimet e fushatës suaj duke kaluar nëpër 'gjarpërinj'; një pengesë për gjarpër.

Pastaj shkruani një zgjidhje realiste për secilën pengesë mbi 'shkallën' dhe ngjiteni mbi gjarpërin relevant.

Për shembull, një pengesë mund të jetë fakti që nuk keni publicitet; një zgjidhje për këtë mund të jetë që të dërgoni një kumtesë për shtyp në një gazetë lokale.



## Hapi 5: ÇFARË keni mësuar nga fushata juaj?

Çfarëdo fushate që nxënësit tuaj zhvillojnë, është shumë me rëndësi që ata – edhe ju – të mund ta masni suksesin e tyre dhe ato çka mësojnë gjatë rrugës.

Aktivitetet në vijim janë disa mënyra në të cilat nxënësit mund ta dokumentojnë suksesin e tyre. Zakonisht është mirë që ata të bëjnë diçka të ngjashme me Tabelën e Vlerësimit për t'i ndihmuar që t'i mbledhin idetë e tyre, dhe më pas t'i regjistrojnë ato që kanë mësuar në një video klip dhe ta shkarkojnë atë në faqen e internetit të fushatës së tyre.

Ky lloj dokumentimi i suksesit të tyre do:

- t'u japë atyre mendime të dobishme lidhur me përmirësimet e mundshme;
- t'ju ndihmojë juve që t'u jepni atyre një notë të saktë në fazën përfundimtare të vlerësimit;
- t'i ndihmojë ata që të analizojnë atë që kanë mësuar dhe mënyrën se si të bëhen fushatë-bërës edhe më të mirë në të ardhmen.

### Aktiviteti 5.1 Tabela e Vlerësimit:

Jepini secilit nxënës një 'tabelë' dhe u kërkoni që të shënojnë me 'X' pjesët që përshkruajnë më së miri mendimet e tyre për fushatë.

### Aktiviteti 5.2 Jeni Yll!

Ngjashëm me Tabelën e Vlerësimit, por u lejon nxënësve që ta arsyetojnë mendimin e tyre.

### Aktiviteti 5.3: Vlerësimi i Shokëve për Fushatën:

Kjo është një kornizë model për nxënësit që ta vlerësojnë njëri-tjetrin. Mbase mund t'ju duhet që ta adaptoni sipas nevojave të nxënësve, por do t'ju japë një ide lidhur me mënyrën se si do ta bëni këtë.

## Tabela e Vlerësimit

**4 = Absolutisht nuk pajtohem**

**3 = Nuk pajtohem**


**2 = Pajtohem**

**1 = Absolutisht pajtohem**

**Vendosni një 'X' në pjesën e tabelës që tregon më së miri mendimin tuaj**

**Mendoj se tani e di më mirë  
se kush e ka pushtetin në  
shkollën/komunitetin/vendin  
tonë/në botë.**

**Mendoj se i kam përmirësuar  
shkathtësitë e mia për  
të bërë fushatë.**



**Mendoj se mund të sjell  
ndryshime duke bërë fushatë.**

**Mendoj se mund të bëj  
fushatë më të mirë  
herën tjetër.**



## Jeni Yll!

<p><b>Çështjet Kyçe</b></p>	<p><b>Sa yje:</b>                      1 yll nëse absolutisht nuk pajtohesh                      5 yje nëse absolutisht pajtohesh</p> 	<p><b>Jepni një shembull konkret nga fushata juaj për ta arsyetuar numrin e yjeve.</b></p>
<p>Tani di më shumë në lidhje me njerëzit që kanë pushtet në shkollën/ komunitetin/vendin/ botën tonë.</p>		
<p>Kam mësuar shumë se si të zhvilloj një fushatë të mirë.</p>		
<p>Kam luajtur rol të plotë në këtë fushatë, kam mbajtur përgjegjësi për detyrat e mia dhe i kam përfunduar ato me kohë.</p>		
<p>Kam menduar në lidhje me fushatën time dhe e di se çfarë do të bëja ndryshe herën tjetër për të sjellë ndryshim.</p>		



***INSTRUMENTI  
SHKOLLOR I  
VETVLERËSIMIT NË  
MËSIMIN E NLM-së***

## 1. UDHËHEQËSIA

Fusha Kryesore Nr.	Fusha Kryesore e NLM-së	Fare i Paktë	Në Zhvillim e Sipër	I Suksesshëm	I Avancuar
<b>1a</b>	Vizioni i shkollës për NLM-në	Nuk ka marrëveshje kolektive apo të shkruar të NLM-së.	Ka një deklaratë ku identifikohet potenciali për një qasje tërëshkollore për NLM.	Ka një deklaratë vizioni të shkruar qartë e cila artikulon qartë qasjen tërëshkollore për NLM-në që e ndan edhe komuniteti shkollor. Shkolla e njeh rëndësinë e NLM-së në lidhjet e shkollës me komunitetin.	Ka një deklaratë vizioni inovativ për NLM-në që pasqyrohet në objektivat e shkollës. Aty njihet ndikimi potencial i NLM-së tek nxënësit, prindërit, personeli, dhe komuniteti. Nxënësit e kuptojnë vizionin dhe kanë mundësi të kontribuojnë.
<b>1b</b>	Udhëheqësia nga drejtori i shkollës	Drejtori i shkollës e kupton shumë pak NLM-në. Përkrahja nga mësimdhënësit dhe prindërit është e kufizuar.	Drejtori i shkollës e kupton rëndësinë dhe vlerën e NLM-së dhe ndikimin potencial të saj në shkollë.	Drejtori i shkollës e kupton plotësisht NLM-në dhe nevojën për përfshirjen e të gjithë aktorëve të komunitetit. Prindërit janë të përfshirë në mënyrë aktive në ngjarjet e NLM-së. Shkolla është e përkushtuar ndaj krijimit të Klubeve të Gjelbra.	Drejtori i shkollës është proaktiv në përkrahjen e grupit udhëheqës që përfshin të gjithë aktorët, dhe ka pritshmëri të larta për ndikimin e NLM-së në përmirësimin e shkollës.
<b>1c</b>	Planifikimi i zhvillimit të NLM-së	Ka planifikim të pakët të NLM-së në shkollë në çfarëdo forme. Shkolla nuk e shfrytëzon Instrumentin e Vetvlërësimit të NLM-së.	Ka një plan të përditësuar për NLM me objektiva të arritshme. Është ndarë një fond financiar për zhvillimin e lëndës.	Ka një plan afatmesëm për NLM të përkrahur nga objektiva. Udhëheqësi lëndor i NLM-së ka shumë vullnet për t'i përfshirë nxënësit në këtë punë. Plani përfshin referenca specifike, ku mundet, për aspektet globale, për shkollat e qëndrueshme, për Klubet e Gjelbra etj.	Ka një plan afatgjatë dhe të detajuar të NLM-së ku tregohen objektivat, zotimet për ta zhvilluar lëndën përgjatë tërë kurrikulimit dhe kulturës së shkollës. Ky plan gjithashtu merr parasysh edhe ndikimin tek komuniteti. Plani rishikohet dhe vlerësohet çdo vit nga nxënësit dhe stafi, dhe po ashtu monitorohen edhe zhvillimet e ndryshme.

<p><b>1d</b></p>	<p>Menaxhimi i NLM-së</p>	<p>Nuk ka udhëheqës lëndor të NLM-së, ose edhe nëse po, ai ka shkathësi të pakta, i mungojnë njohuritë dhe të kuptuarit, dhe ka ndikim minimal.</p>	<p>Udhëheqësi lëndor i NLM-së ka njëfarë trajnimi, ka zhvilluar njohuri, dhe i përkrah ata individë që japin NLM-në mësim në lëndët e veta.</p>	<p>Ka një udhëheqës lëndor të NLM-së me përvojë dhe të shkathët, me njohuri të gjera të fushës, i cili drejton dhe koordinon tërë qasjen e shkollës. Nxënësit inkurajohen nga mësimdhënësit e NLM-së për të kontribuar në planifikimin e kurrikulumit.</p>	<p>Udhëheqësi lëndor i NLM-së është jashtëzakonisht i shkathët dhe i trajnuar, dhe është në gjendje të motivojë stafin, gëzon përkrahjen e drejtorit të shkollës dhe të të gjithë mësimdhënëseve, përfshin komunitetin dhe ngre zërin për çështje të NLM-së në tërë shkollën.</p>
<p><b>1e</b></p>	<p>Vendimmarrja kyçe</p>	<p>Reagimet ndaj iniciativave janë të shpërndara dhe ndodhin pa konsultimin e duhur.</p>	<p>Udhëheqësi lëndor i NLM-së e diskuton NLM-në me ekipin e administratës.</p>	<p>NLM-ja diskutohet rregullisht me takimet e personelit apo të grupit qeverisës të shkollës, ku shqyrtohen nevojat dhe mendimet e nxënësve.</p>	<p>Ka një Klub të Gjelbër proaktiv për NLM-në i cili përfshin një grup nxënësish të zgjedhur në mënyrë demokratike, që mbledhet shpesh dhe e çon NLM-në përpara. Ai gjithashtu përfshin prindër dhe anëtarë të komunitetit.</p>
<p><b>1f</b></p>	<p>Caktimi i orareve</p>	<p>NLM-ja nuk është e caktuar në orar; ka njëfarë vendi në lëndë të tjera ose në "jetën e gjërë shkollë". Zhvillohet pak ose aspak vlerësim, shënim apo raportim mbi NLM-në.</p>	<p>NLM lidhet me një ose dy lëndë, por pa kapacitetin për të ofruar gamën dhe thellësinë e duhur të studimit. Vlerësimi është ose inekzistent, ose administrohet shumë dobët.</p>	<p>NLM-ja është një lëndë më vete në orarin mësimor ose lëndë me elemente thelbësore të përcaktuara mirë brenda kurrikulumit më të gjërë. Ka vlerësim, shënim dhe raportim efektiv.</p>	<p>NLM-ja është lëndë solide në shkollë; ka status dhe ka staf komplet i cili është i përgatitur. Nuk ka konflikte me lëndët e tjera. Përveç orëve të mësimi, orari përfshin një sërë aktivitete të tjera.</p>
<p><b>1g</b></p>	<p>Punësimi dhe emërimi i personelit</p>	<p>Nuk ka personel të trajnuar për NLM. Mësimdhënësi përgjegjës mund të mos e njohë fushën dhe qasjet në mësimdhënie dhe nxënie. Supozohet që cilido mësimdhënësi mund të mbajë mësim në fushën e NLM-së.</p>	<p>Shkolla mund të mos ketë punësuar specialistë, por ka identifikuar një udhëheqës lëndor entuziast të interesuar për zhvillim profesional dhe ka kapacitetin për të drejtuar trajnimet në shkollë.</p>	<p>Shkolla ka punësuar një mësimdhënësi të trajnuar për NLM për të drejtuar lëndën, dhe i ka kërkuar krijimin e një ekipi për mësimdhënie e NLM-së. Udhëheqësi lëndor është përgjegjës për NLM-në në mbarë shkollën, si dhe për mësimdhënie e kësaj fushë.</p>	<p>Shkolla sigurohet që të ketë një trupë të plotësuar të personelit të trajnuar të NLM-së. Shkolla i inkurajon ata ta udhëheqin rolin e NLM-së përtej klasës. Ekipi i NLM-së ofron ngritje profesionale (NPM) për anëtarë e tjerë të stafit, për shkollat lokale, dhe për partnerët e komunitetit.</p>



## 2. BURIMET DHE MENAXHIMI I TYRE

Fusha Kryesore Nr.	Fusha Kryesore e NLM-së	Fare i Paktë	Në Zhvillim e Sipër	I Suksesshëm	I Avancuar
<b>2a</b>	Cilësia e resurseve për mësimdhënien dhe nxënien e NLM-së	Ka resurse të pakta për mësimdhënien e NLM-së. Ato që janë në dispozicion janë të vjetra. Mësimdhënësit mbështeten së tepërmi në një burim të vetëm i cili jo gjithmonë plotëson nevojat e nxënësve.	Ndonëse ka burime të mjaftueshme moderne, shkolla ka identifikuar zbrastëra në sigurimin e burimeve.	Ka një gamë të gjerë burimesh ku kanë qasje mësimdhënësit dhe nxënësit. Nxënësit kanë mundësi të kenë qasje në resurse dhe t'i zgjedhin ato vetë. Mjete dhe instrumente të ndryshme të TIK-ut përdoren në mënyrë efikase.	Ekziston një gamë e gjerë resursh cilësore, përfshirë edhe materialet me bazë në internet. Nxënësit kanë kontribuar në krijimin e burimeve. Këto të fundit u referohen qartë të gjitha aspektëve të NLM-së. Të gjitha resurset përputhen me nevojat, dhe mbështesin përfshirjen dhe diversitetin.
<b>2b</b>	Qasja në burime	Qasja nuk është e qartë. Për shembull, shpërndarja e resurseve varet nga udhëheqësi lëndor i NLM-së.	Ekziston një bërthamë burimesh të përshtatshme për disa lëndë dhe në bibliotekën e shkollës.	Të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit kanë qasje në një gamë të gjerë resursh. Ka burime të mira për përkrahjen e mësimdhënies thelbësore në NLM, përfshirë CD ROM dhe mediume të ndryshme, si dhe teknologji me bazë në internet.	Të gjithë nxënësit kanë mundësi ta shfrytëzojnë komunitetin e tyre si burim dhe kanë qasje në vizita, aktivitete të vizitorëve, burime nga interneti, të përshtatura sipas kurrikulumit dhe nevojave të tyre. Ka burime të mira që përkrahin mësimdhënien dhe nxënien e NLM-së.
<b>2c</b>	Përdorimi i burimeve në NLM	Mbështetja tek detyrat nga burimet e fotokopjuara apo libri shkollor është tepër e madhe.	Shfrytëzohen burime të përshtatshme për përkrahjen e NLM-së, por mënyra si përdoren nuk ka fokus të qartë dhe nuk është sfiduese sa duhet.	Burimet përputhen me përmbajtjen e mësimin dhe përdoret një kombinim i qasjeve të mësimdhënies dhe nxënies.	Burimet zgjidhen të atilla që të përkrahin një gamë të gjerë të qasjeve të mësimdhënies dhe nxënies. Ka program për zëvendësimin dhe blerjen e burimeve më të reja.

### 3. MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA

Fusha Kryesore Nr.	Fusha Kryesore e NLM-së	Fare i Paktë	Në Zhvillim e Sipër	I Suksesshëm	I Avancuar
<b>3a</b>	NLM-ja në kurrikulum	NLM-ja është e fragmentuar. Nuk ka skemë pune ose mungojnë detajet dhe vazhdimësia dhe referencat e mjaftueshme ndaj aspekteve kyçe të kurrikulumit.	Ekziston një grup elementar aktivitësh mësimore për NLM që pasqyrojnë konceptet kyçe dhe shkathtësitë kyçe në kurrikulum. Ka program pune të informuar nga kurrikulumit kombëtar ose nga planet e vetë shkollës për NLM. Siguron vazhdimësinë e të nxënimit në tërë shkollën.	Mësimdhënësit klasorë kanë një kurrikulum të planifikuar mirë dhe të hollësishtëm në fushën e NLM-së, i cili tregon se burimet kyçe janë shfrytëzuar me efikasitet.	Të gjithë mësimdhënësit klasorë e njohin mirë kurrikulumin. Puna kontrollon dhe zhvillohet rregullisht. Pjesëmarrja e nxënësve planifikohet, monitorohet dhe kontrollohet nga personeli dhe nga një grup nxënësish i zgjedhur në mënyrë demokratike.
<b>3b</b>	Planet Mësimore	Planet mësimore kanë objektiva të paqarta të të nxënimit, ose shprehin keqkuptim të synimeve të kurrikulumit të NLM-së.	Pjesa më e madhe e planeve mësimore kanë objektiva të të nxënimit të cilat janë të fokusuar qartë. Mësimdhënësit i përdorin planet dhe resurset mësimore në mënyrë selektive.	Ekzistojnë plane mësimore të hollësishtë të ndërhuara rreth koncepteve dhe proceseve në NLM. Jepen mundësi për reflektim lidhur me të nxënimit.	Orët mësimore lidhur me NLM janë të planifikuara shumë mirë. Mësimdhënësit e kanë kuptuar se si mund të udhëhiqet mësimi dhe një sërë orësh përmes shfrytëzimit të koncepteve dhe proceseve.
<b>3c</b>	Mësimdhënia dhe nxënësia	Mësimdhënësit janë të paqartë lidhur me qëllimin e mësimimit, dhe shfrytëzojnë një gamë të ngushtë të stileve mësimore. Shumica e nxënësve nuk shënojnë përparim në të nxënë.	Mësimet kanë tipare të mira, por mësimdhënësit kanë pritshmëri jo aq të larta sa duhet lidhur me gamën dhe thellësinë e punës që pritet. Shumica e nxënësve shënojnë njëfarë përparimi.	Mësimdhënësit përdorin një gamë të gjerë të qasjeve të mësimdhënies dhe nxënies për ta përcjellë NLM-në me nivel të lartë ndërveprimi mes nxënësve. Shumica e nxënësve shënojnë përparim të konsiderueshëm.	Qasjet e mësimdhënies dhe nxënies përputhen me përmbajtjen mësimore dhe me të nxënimit e nxënësve, duke nxitur pjesëmarrjen e çdo nxënësi. Shumica e nxënësve shënojnë përparim shumë të lartë.
<b>3d</b>	Vlerësimi	Mësimdhënësit vlerësojnë përparimin e nxënësve në mënyrë arbitrare, e nganjëherë nuk vlerësojnë fare, dhe kjo nuk raportohet tek të gjithë prindërit. Nuk ka një politikë gjithëpërfshirëse, dhe mësimdhënësit nuk e kuptojnë rëndësinë e vlerësimit në NLM.	Vlerësimi zhvillohet, por i mungon rigoroziteti. Nuk ka mekanizëm për nxjerrjen e rezultateve nga këto vlerësime për të treguar përparimin e shënuar gjatë një kohe. Shkolla nuk e ka kuptuar mirë vlerësimin e përparimit në NLM.	Përparimi në NLM vlerësohet dhe raportohet në mënyrë të plotë. Në planifikimet e ardhshme të punës merret parasysh përshkrimi i niveleve. Mësimdhënësit e kuptojnë dallimin mes vlerësimit për të nxënë dhe vlerësimit të të nxënimit. Nxënësit vlerësojnë punën e tyre. Përparimi i shënuar u raportohet plotësisht prindërve dhe komentohet në raporte.	Vlerësimi është në përputhje me procesin dhe i përfshin plotësisht nxënësit si dhe identifikon dhe përgëzon arritjet e tyre. Nxënësit komentojnë si mbi përparimin e tyre, ashtu edhe mbi mënyrat e përmirësimit. Vlerësimi identifikon nevojat dhe prioritetet e mëtejshme për planifikimin e punës në të ardhmen.

<p><b>3e</b></p>	<p>Shënim i dhe raportimi</p>	<p>Nuk ka proces formal për shënimin e progresit apo raportim për mësimin e NLM-së tek prindërit.</p>	<p>Shkolla është e vetëdijshme për përgjegjësitë e veta lidhur me shënimin dhe raportimin, por referencat ndaj NLM-së mbyten nga raportet mbi lëndët e tjera. Nuk ka vazhdimësi të qartë të njohurive, shkathërsive apo të kuptuarit.</p>	<p>Ka një raport të veçantë të lëndës ku raportohet se është ecur përpara në tërë NLM-në në fushën e koncepteve thelbësore, proceseve kryesore, dhe pjesëmarrjes së nxënësve përtej klasës.</p>	<p>Mësimdhënësit dhe nxënësit bashkëpunojnë në monitorimin e përparimit. Nxënësit janë të angazhuar në mënyrë aktive në procesin e raportimit bashkë me partnerët kyçë nga komuniteti.</p>
<p><b>3f</b></p>	<p>Arritjet</p>	<p>Nxënësit nuk e dinë çfarë pritet prej tyre në NLM.</p>	<p>Nxënësit e dinë çfarë pritet prej tyre, por pritet e mësimdhënëse janë të ulëta dhe nuk merren parasysh aktivitetet në të cilat nxënësit mund të përfshihen jashtë shkollës.</p>	<p>Nxënësit i kanë të qarta prirjet në fushën e NLM-së. Arritjet në NLM si gjatë mësimin në shkollë, ashtu edhe jashtë saj njihen dhe evidentohen nga shkolla. Po ashtu, njihen meritat e pjesëmarrjes aktive në jetën shkollore dhe në komunitet. Nxënësit identifikojnë dhe reflektojnë mbi përparimin e shënuar në lidhje me synimet e NLM-së.</p>	<p>Nxënësit arrijnë rezultate të mira dhe shënojnë përparim të lartë. Ata i caktojnë vetë synimet e tyre dhe i orientojnë përpjekjet e tyre drejt fushave ku ka nevojë. Shënohen arritje shumë të larta. Arritjet e të gjithë nxënësve evidentohen dhe certifikohen.</p>
<p><b>3g</b></p>	<p>Teknologjia Informative dhe e Komunikacionit (TIK)</p>	<p>TIK-u nuk përdoret fare në mësimdhënien e NLM-së.</p>	<p>Mësimdhënësit e përdorin nganjëherë TIK-un në mësimdhënie dhe nxënie.</p>	<p>Të gjithë mësimdhënësit e NLM-së përdorin një sërë aktivitetesh dhe resurseth nga TIK-u për të mbështetur mësimdhënien dhe nxënien. Klasa dhe shkolla pasqyrojnë përdorimin e gjerë të TIK-it. Nxënësit e përdorin rregullisht TIK-un për të përkrahur punën e tyre në NLM.</p>	<p>Të gjithë mësimdhënësit e NLM-së e përdorin TIK-un në mënyrë shumë kreative. Nxënësit e përdorin TIK-un në mënyrë të pavarur për të përkrahur punën e tyre në NLM. Ekspozimet e punimeve të nxënësve në klasë dhe shkollë tregojnë përdorim inovativ të TIK-it në NLM.</p>
<p><b>3h</b></p>	<p>Pjesëmarrja e Nxënësve në Shkollë</p>	<p>Nxënësit kanë mundësi të pakta pjesëmarrjeje në vendimmarrje në çfarëdo niveli, qoftë për sa u përket mësimëve e NLM-së apo më gjerë në jetën shkollore. Nuk bëhet asnjë lidhje mes asaj që ndodh në mësimet e NLM-së dhe zërit të nxënësit.</p>	<p>Disa mësimdhënësit kanë siguruar mundësinë e pjesëmarrjes përtej klasës. Mësimdhënësit kanë filluar të planifikojnë aktivite në NLM mësimore të cilat mund të ofrojnë informata për diskutime dhe debate në këshillin e shkollës.</p>	<p>Ekziston një politikë e koordinuar që u mundëson nxënësve të marrin pjesë si në shkollë, ashtu edhe jashtë saj, duke marrë parasysh mundësitë që ofron kurrikulumin për NLM. Shkolla e vlerëson zërin e nxënësve dhe i nxit ata që të mendojnë se si mund të ndërmarrin veprime efektive lidhur me shqetësimet që mund të kenë. Nxënësit përdorin shkathërsitë e tyre të pjesëmarrjes për udhëheqjen e aktivitetëve.</p>	<p>Nxënësit dhe mësimdhënësit punojnë së bashku. Shkolla aspiron të jetë një shkollë demokratike. Nxënësit mbajnë përgjegjësi për aktivitetet në shkollë dhe në komunitet. Shkolla e sheh pjesëmarrjen e nxënësve si element qendror të përmirësimit, dhe mësimet e NLM-së janë katalizator për shkathërsitë e nxënësve në këtë aspekt.</p>

## 4. ZHVILLIMI I PERSONELIT

Fusha Kryesore Nr.	Fusha Kryesore e NLM-së	Fare i Paktë	Në Zhvillim e Sipër	I Suksesshëm	I Avancuar
<b>4a</b>	Auditimi i shkathhtësive dhe ekspertizës së personelit	Nuk është bërë asnjë auditim i strukturuar. Askush nuk e di cilat shkathhtësi mund t'i kenë mësimdhënësit për mësimdhënien e aspekteve të NLM-së.	Është bërë auditimi dhe janë identifikuar zbrazëtitë në fusha të zhvillimit në tërë shkollën. Si rezultat i kësaj disa mësimdhënës kanë marrë pjesë në trajnime.	Është bërë auditimi i shkathhtësive dhe mësimdhënës-it me shkathhtësi të veçanta janë në gjendje ta ndajnë përvojën e vet me mësimdhënës-it tjerë të NLM-së.	Auditimet përdoren rregullisht për t'i identifikuar nevojat individuale si edhe ato që vlejné për tërë shkollën dhe për tu siguruar se plotësohen të drejtat e nxënësve.
<b>4b</b>	Ngritja Profesionale e Mësimdhënësve (NPM)	Vetëm disa mësimdhënës kanë marrë pjesë në ndonjë NPM/ NLM.	NLM-ja është e përfshirë në programin NPM të shkollës. Udhëheqësi lëndor i NLM-së e përdor deri diku Doracakun NPM/NLM.	NPM-ja është pjesë e integruar e planit zhvillimor të shkollës dhe planit strategjik për NLM. Doracak i NPM/ NLM përdoret në mënyrë efektive. Ekziston mundësia për ata që kanë marrë pjesë në NPM ta informojnë personelin dhe ta përdorin të nxënërit për ta përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënërit.	I gjithë personeli ka qasje në NPM/ NLM përmes planit përkrahës të shkollës për ngritje profesionale të mësimdhënësve. Informatat bazë i ofrohen mësimdhënësve të rinj dhe ka mundësi për pjesëmarrje në certifikim të NPM/ NLM për të gjithë mësimdhënësit lëndorë dhe të tjerë. Ekzistojnë dëshmi se NPM ka pas ndikim në zbatimin e NLM-së, sidomos për mësimdhënien dhe të nxënërit.

## 5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Fusha Kryesore Nr.	Fusha Kryesore e NLM-së	Fare i Paktë	Në Zhvillim e Sipër	I Suksesshëm	I Avancuar
<b>5a</b>	Monitorimi dhe Vlerësimi i NLM-së	Nuk ka ndonjë proces formal të monitorimit.	Udhëheqësi lëndor i NLM-së i monitoron mësimdhënësit e NLM-së kur paraqitet nevoja. Kjo mund të përfshijë vëzhgimin në orë dhe analizimin e planifikimit.	Ekziston monitorim i rregullt dhe i planifikuar i ofrimit të NLM-së për tërë shkollën, duke përfshirë vëzhgimin e orëve, analizimin e punës dhe planifikimit. Mjeti për Vetëvlerësim NLM përdoret gjatë planifikimit.	Mësimdhënësit e vëzhgojnë njëri-tjetrin rregullisht. Nxënësit ofrojnë informata për mësimet dhe janë shumë të përfshirë në procesin e monitorimit dhe vlerësimin, duke i identifikuar çështjet për zhvillim dhe ndryshim. Kjo i jep zë të nxënëtit të personalizuar. Prindërve u ofrohen raportet.
<b>5b</b>	Rishikimi	Nuk ka ndonjë rishikim të NLM-së.	Udhëheqësi lëndor i NLM-së e monitoron mësimdhënien e NLM-së por kjo nuk diskutohet shpesh në praninë e të gjithëve.	NLM-ja diskutohet rregullisht në takime dhe identifikohen çështjet për zhvillim të ardhshëm. NLM-ja rishikohet në bazë vjetore nga personeli kryesor dhe hartohet një plan i veprimit nga udhëheqësi lëndor i NLM-së.	NLM-ja diskutohet nga nxënësit dhe personeli në takime të ndryshme. Rishikimi bëhet në bazë vjetore nga nxënësit, personeli dhe anëtarët e komunitetit të gjerë. Kjo ofron informata për planifikimin e shkollës. Ndodh monitorimi efektiv i zhvillimit.



## 6. PËRFSHIRJA E PRINDËRVE/KOMUNITETIT

Fusha Kryesore Nr.	Fusha Kryesore e NLM-së	Fare i Paktë	Në Zhvillim e Sipër	I Suksesshëm	I Avancuar
<b>6a</b>	Përfshirja e prindërve në NLM	Prindërit dhe të tjerët shfrytëzohen si vizitorë në bazë individuale dhe aty për aty. Nuk ka ndonjë politikë apo udhëzim. Prindërit nuk u ofrohet ndonjë informatë për NLM-së.	Planet shkollore për përfshirjen e prindërve dhe anëtarëve të komunitetit janë në pajtim me politikën e shkollës. Shkolla i informon prindërit për NLM.	Prindërit dhe anëtarët e komunitetit ofrojnë përkrahje për kurrikulin e NLM-së dhe marrin udhëzime të qarta për rolin dhe qëllimin e tyre. Përfshirja e tyre është e planifikuar mirë dhe përfshirja e vizitorëve të huaj monitorohet dhe vlerësohet nga personeli dhe nxënësit.	Prindërit dhe anëtarët e komunitetit janë të përfshirë në shumë aspekte të aktiviteteve të planifikimit në bashkëpunim/partneritet me udhëheqësit lëndor të NLM-së. Prindërit janë përkrahës entuziastë të Klubeve të Gjelbra.
<b>6b</b>	Organizatat qeveritare dhe organizatat joqeveritare	Nuk shfrytëzohen ofruesit.	Shkolla i shfrytëzon deri diku agjencitë dhe burimet lokale dhe kombëtare.	Baza e burimeve lokale të komunitetit dhe vullnetare është krijuar dhe është planifikuar shfrytëzimi i tyre për NLM, sidomos për Klube të Gjelbra.	Anëtarët e komunitetit organizojnë përkrahje dhe iniciojnë aktivitete në shkollë si Klubet e Gjelbra. Nxënësit dhe mësimmëdhënësit ftojnë folës për ta ngritur vetëdijen.
<b>6c</b>	Informimi i prindërve dhe komunitetit lokal	Prindërit dhe komuniteti nuk janë të vetëdijshëm për qasjen e shkollës ndaj NLM-së.	Informatat janë në dispozicion për komunitetin në letrat informative të shkollës. Prindërit e dinë çka mësojnë fëmijët e tyre.	Prindërit dhe komuniteti informohen rregullisht përmes letrave të rregullta informative, ueb faqes së shkollës dhe pjesëmarrjes në aktivitete të NLM-së.	Prindërit dhe komuniteti ftohen të marrin pjesë në punëtorë për aspektet specifike të NLM-së, si çështjet lokale, riciklimi, mbeturinat, ndryshimet klimatike, zvogëlimi i shfrytëzimit të energjisë, Klubet e Gjelbra dhe ndërlicha e shkollës. Prindërit dhe anëtarët e komunitetit ftohen si folës apo pjesëmarrës në diskutime.

